



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 7 regjistër (JR)
Datë 16.02.2024

Nr. 36 i vendimit
Datë 18.07.2024

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 18.07.2024, ditën e enjte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar Francesco Ciardi, me sekretare gjyqësore Griselda Muça, çështjen nr. 7/2024 (JR), datë 16.02.2024, që i përket:

ANKUES:

Subjekti i rivlerësimit Dorjan Tafilaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

OBJEKTI:

Shqyrtimi i vendimit nr. 728, datë 28.12.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 728, datë 28.12.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Dorjan Tafilaj ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, iu nënshtua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar brenda afatit ligjor në organet ndihmëse përkatëse deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit (në vijim “deklarata *vetting*”), në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), deklaratën për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, (në vijim “DSIK”), si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional pranë Prokurorisë së Përgjithshme.
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).
 - 3.1. ILDKPKI-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt rivlerësimi, ka konstatuar se: - *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin*; - *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; - *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; - *nuk ka kryer deklarim të rremë*; - *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.
 - 3.2. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve në deklaratën për kontrollin e figurës dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar në Komision një raport të arsyetuar.
 - 3.3. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës së rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.

4. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLP-ja, si më sipër, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Dorjan Tafilaj bazuar në tri kriteret e vlerësimit, duke marrë në përfundim të procesit vendimin nr. 728, datë 28.12.2023.

II. Vendimi i Komisionit

5. Komisioni, në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që ka disponuar për kriteret e vlerësimit të pasurisë, vlerësimit të figurës dhe vlerësimit profesional, si dhe në vlerësimin tërësor të procedurave, ka arritur në përfundimin se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë dhe ka pamjaftueshmëri të burimeve financiare, lidhur me pasuritë e krijuara prej tij dhe prej bashkëshortes, duke rezultuar me një mungesë burimesh të ligjshme prej (-) 4.547.888 lekësh, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Në rastin e subjektit të rivlerësimit Dorjan Tafilaj, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni ka vlerësuar se vërtetohen shkaqet që neni D i Aneksit të Kushtetutës i ka parashikuar të tilla që të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit, për shkak se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pasuritë në mënyrë të pasaktë.
6. Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni çmoi se subjekti i rivlerësimit Dorjan Tafilaj:
 - a) nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016;
 - b) ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016;
 - c) ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c”, të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.
7. Në përfundim, Komisioni, referuar pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, vendosi: *“Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Dorjan Tafilaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”*.

III. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me vendimin e Komisionit

8. Subjekti i rivlerësimit Dorjan Tafilaj ka paraqitur në Kolegj ankim kundër vendimit të Komisionit, duke kërkuar nga Kolegji gjykimin e çështjes në seancë publike, ndryshimin e vendimit nr. 728, datë 28.12.2023, të Komisionit dhe konfirmimin e tij në detyrë. Këto kërtime janë përsëritur nga subjekti i rivlerësimit edhe në parashtrimet me shkrim të datës 11.07.2024, të paraqitura përpara seancës në dhomë këshillimi.
9. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit mbi procesin e rregullt dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si vijojnë.

9.1. Subjekti i rivlerësimit parashtron në ankimin drejtuar Kolegjit se Komisioni nuk ka respektuar procedurën e marrjes së provave, në kundërshtim me përcaktimet e neneve 49/3 dhe 49/4 të ligjit nr. 84/2016, neneve 25 dhe 34 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizmin dhe funksionimin

e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe nuk ka respektuar procedurën e vlerësimit të provave, në kundërshtim me nenet 48 dhe 81 të Kodit të Procedurave Administrative. Subjekti i rivlerësimit pretendon se shpjegimet e dhëna prej tij gjatë procesit të rivlerësimit lidhur me të ardhurat nga ndihma ekonomike për paaftësi, vërtetuar nga Komisioni Epror Mjekësor Parësor (në vijim “KEMP”)¹, përfituar nga djali, si dhe aktet që janë dorëzuar prej tij për këtë qëllim, nuk i janë nënshtruar vlerësimit nga Komisioni, sipas parashikimeve ligjore dhe standardeve të procesit të rregullt ligjor.

9.2. Subjekti pretendon se Komisioni, në shkelje të parimit të kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve, i ka mohuar të drejtën për t’u dëgjuar në proces, për të prapësuar dhe për të paraqitur kundërarargumentet lidhur me mospërfshirjen e të ardhurave të përfituara nga KEMP në analizën financiare përfundimtare, pjesë përbërëse e vendimit. Komisioni, gjatë të gjithë fazave të procesit të rivlerësimit, ka përfshirë të ardhurat nga KEMP si pjesë përbërëse e hetimit dhe i ka përfshirë këto të ardhura në analizën financiare të dërguar së bashku me rezultatet e hetimit, si dhe ka vijuar t’i përfshijë këto të ardhura gjatë relativitetit të konkluzioneve në seancën dëgjimore të datës 27.12.2023. Ndryshimi i qëndrimit të Komisionit për mospërfshirjen e të ardhurave është reflektuar vetëm në vendimin përfundimtar, duke u gjendur në shkelje procedurale, pasi subjektit nuk i është dhënë asnjë mundësi për të paraqitur shpjegimet dhe kundërarargumentet mbi këtë çështje.

9.3. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni në shkelje të ligjit procedural nuk ka respektuar të drejtën për t’u dëgjuar dhe nuk i ka dhënë mundësinë për të debatuar rezultatin e analizës financiare për periudhën 1998-2003, duke i mohuar të drejtën për të paraqitur prova të tjera në kuadër të mbrojtjes së tij në proces. Nga arsyetimi i dhënë nga Komisioni në vendim, nuk është përcaktuar ndonjë element referues për kryerjen e kësaj analize dhe njëkohësisht subjekti pretendon se nuk ka pasur në asnjë moment të drejtën në proces për të kundërshtuar këtë gjetje të Komisionit të pasqyruar në vendimin përfundimtar.

10. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit, në ankimin drejtuar Kolegjit, ka parashtruar se:

- Për analizën financiare për periudhën 1998-2003

11. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me konkluzionet e Komisionit, pretendon se Komisioni ka përjashtuar padrejtësisht nga analiza financiare të ardhurat e prindërve për këtë periudhë, si dhe ka kryer një analizë të pamjaftueshme të mundësisë së prindërve për të krijuar kursime në vlerën prej 1.500.000 lekësh. Sipas subjektit, analiza financiare e kryer nga Komisioni, lidhur me mundësinë e prindërve për të kursyer vlerën prej 1.500.000 lekësh, nuk është realizuar në përputhje me parashikimet ligjore dhe procedurën e duhur. Komisioni nuk ka përcaktuar termat e kryerjes së analizës, pasi të ardhurat e prindërve janë gjeneruar ndër vite dhe jo vetëm në periudhën objekt analize. Për më tepër, babai D. T. ka pasur edhe të ardhura të tjera të ligjshme, nga puna e tij në sektorin privat pas daljes në pension. Këto të ardhura, si pasojë e mbushjes së moshës së pensionit

¹ Subjekti i rivlerësimit si dhe Komisioni i referohen Komisionit Epror Mjekësor Parësor (KEMP), ndërkohë që sipas ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, invaliditeti caktohet nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë të Invalidëve (KMCAP).

të pleqërisë, nuk janë reflektuar në dokumentacionin e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, por që do të paraqiten në vijim prej tij në proces.

- Për pasurinë apartament me sip. 86 m², të blerë në vitin 2007

12. Për pasurinë apartament banimi në Vlorë, subjekti pretendon se nga Komisioni është përcaktuar në mënyrë subjektive pamjaftueshmëria në burime financiare, në vlerën prej (-) 440.963 lekësh, pasi nuk janë marrë në konsideratë në analizë të ardhurat e përfituara nga KEMP-i për djalin, si dhe nuk është kryer nga Komisioni zbritja e shpenzimeve të jetesës për vitet 2005-2007.

- Për automjetin tip "Ford Focus" blerë në vitin 2015

13. Subjekti pretendon se konkluzioni i Komisionit, për pamundësi financiare për blerjen e këtij automjeti, nuk është në përputhje me analizën financiare të kryer nga vetë Komisioni në pikën 13.4 të vendimit, ku nga analiza konstatohet një pamundësi në vlerën prej (-) 282.832 lekësh. Komisioni ka kryer një analizë financiare të pamjaftueshme dhe joproporcionale, pasi nuk ka konsideruar në analizën për blerjen e automjetit tepricën e gjendjes *cash* të mbartur nga viti paraardhës 2014.

- Lidhur me mjaftueshmërinë financiare dhe deklarinë e llogarive bankare

14. Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit se është në pamundësi financiare për krijimin e llogarive bankare, përkatësisht të depozitës 5.000 euro, në datën 27.08.2009, në ProCredit Bank, të depozitës 5.000 euro, në datën 12.03.2010, në ProCredit Bank dhe të depozitës 600.000 lekë, në datën 05.04.2012, në BKT, pasi Komisioni për këto depozita nuk ka përfshirë në analizë tepricat *cash* të kursyera në vitet paraardhëse të krijimit të depozitave.

- Lidhur me llogaritjen e gjendjes cash

15. Subjekti parashtron në ankim se analiza e kryer nga Komisioni mbi ndryshimin e gjendjes *cash* nuk është në koherencë me leximin dhe interpretimin e drejtë të deklarimeve në deklaratat periodike vjetore dhe të vlerës provuese të tyre, sipas parashikimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka bërë përllogaritje të gabuara të gjendjes *cash*, pasi nuk ka marrë në konsideratë përdorimin e gjendjes *cash* në shpenzimet për blerjen e automjeteve, çeljen e llogarive bankare, si dhe shlyerjen e detyrimeve në vite. Gjithashtu, subjekti kundërshton dhe gjetjen e Komisionit se në fund të vitit 2016 është mbajtur një gjendje *cash* në vlerën 2.200.000 lekë, që tejkalon vlerën limit prej 1.500.000 lekësh që lejohet sipas ligjit. Sipas subjektit, ai ka qenë në kushtet e mbrojtjes së nevojshme për shkak të rrethanave të veçanta të kësaj periudhe, pasi ai dhe familja e tij kanë qenë të ekspozuar ndaj sulmeve kriminale. Në këto rrethana, subjekti ka mbajtur një gjendje *cash* tej limitit të lejuar, me qëllim për të siguruar mbrojtjen e familjes në rast emergjence të largimit nga qyteti ku banonin apo jashtë vendit.

- Për automjetin tip "Volkswagen Golf" blerë në vitin 2010

16. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për pamjaftueshmëri financiare në vlerën prej (-) 56.627 lekësh, për blerjen e këtij automjeti, pasi, sipas tij, Komisioni ka kryer një analizë financiare të pamjaftueshme dhe joproporcionale, duke mos konsideruar në analizë tepricën e gjendjes *cash* të mbartur nga viti paraardhës 2009.

17. Subjekti parashtron në ankim se Komisioni nuk ka kryer një vlerësim proporcional dhe të drejtë, lidhur me pasuritë e luajtshme të krijuara nga subjekti, dy automjetet, të cilat janë dëmtuar/grabitur për shkak të atentateve që janë kryer ndaj tij në datat 29.06.2013 dhe 18.11.2014. Për të dy automjetet, subjekti pretendon se duhet t'i jepej dëmshpërblim ose kompensim nga ana e organeve ligjzbatuese, sepse ato janë dëmtuar për shkak të detyrës, dhe se nuk janë zbuluar autorët ndaj të cilëve subjekti mund të kishte kërkuar dëmshpërblim financiar me padi civile.
18. Në përfundim, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti pretendon se Komisioni ka shkelur parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, pasi në kushtet kur burimet e ligjshme të pasurisë nuk janë bërë pjesë e analizës financiare, kjo analizë dhe vlerësimi i pasurisë në tërësi nuk rezultojnë si një produkt i raportit real të të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera.
19. Bashkë me ankimin e depozituar në Komision në datën 07.02.2024, subjekti i rivlerësimit ka bërë kërkesë dhe ka depozituar në datën 08.02.2024, protokolluar në Komision me nr. {***} prot. dhe aktet:
 - i) vërtetim nr. {***}, datë 02.08.2023, i Bashkisë Vlorë, mbi të ardhurat e përfituara nga ndihma ekonomike nga E. T.;
 - ii) kopje të komunikimit me *e-mail* me Komisionin, datë 18.12.2023, për dërgimin e disa akteve.
20. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Kolegj, në datën 24.05.2024, një kërkesë protokolluar me nr. {***} prot., me anë të së cilës ka kërkuar nga Kolegji marrjen në konsideratë dhe shqyrtimin e vërtetimit nr. {***} prot., datë 23.04.2024, lëshuar nga shoqëria “{***}” ShPK., për të ardhurat e përfituara nga babai i tij D. T. si konsulent i jashtëm në disa projekte të zhvilluara nga kjo shoqëri. Sipas subjektit, analiza financiare për periudhën 1998-2003 është kryer nga Komisioni në shkelje të parashikimeve ligjore, pasi nuk janë përfshirë të ardhurat e ligjshme të prindërve të tij. Subjekti pretendon se Komisioni nuk i ka dhënë mundësinë për të paraqitur shpjegimet dhe kundërgargumentet lidhur me të ardhurat e prindërve, duke e vendosur në pamundësi objektive për të paraqitur dokumentacionin përkatës brenda afateve ligjore.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Mbi juridiksionin e Kolegjit

21. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim që ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Mbi legjitimimin e ankuesit

22. Ankuesi Dorjan Tafilaj, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ka ushtuar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe, në zbatim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, legjitimohet *ratione personae* për të ankimuar vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
23. Vendimi i Komisionit për subjektin e rivlerësimit Dorjan Tafilaj është shpallur në seancë publike më datë 28.12.2023. Vendimi i arsyetuar nr. 728, datë 28.12.2023, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***}, datë 24.01.2024, të Komisionit, për të cilën subjekti i rivlerësimit ka marrë dijeni më datë 01.02.2024. Subjekti i rivlerësimit ka përcjellë në datën 07.02.2024 pranë Komisionit ankimin e tij kundër vendimit të Komisionit nr. 728, datë 28.12.2023, protokolluar me nr. {***} prot., datë 07.02.2024. Bazuar në nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit dhe subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione temporis*.

c) Mbi formën e gjyqimit të ankimit

24. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit, në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur, trupi gjykues, në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim ligji nr. 49/2012), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve.
25. Trupi gjykues, referuar nenit 47² të ligjit nr. 49/2012, shqyrtoi aktet e paraqitura bashkëlidhur ankimit dhe parashtrimeve para seancës, për të cilat subjekti i rivlerësimit ka kërkuar të merren në cilësinë e provës. Nga shqyrtimi i akteve: *vërtetim nr. {***}, datë 02.08.2023, i Bashkisë Vlorë, mbi të ardhurat e përfituara nga ndihma ekonomike nga E. T.; si dhe kopje të komunikimit me e-mail me Komisionin, datë 18.12.2023*, trupi gjykues konstatoi se këto akte janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në Komision me e-mail në datën 18.12.2023, së bashku me kopje elektronike të prapësimeve ndaj rezultateve të hetimit dhe dokumentacionit përkatës dhe ndodhen në fashikujt e Komisionit. Ndërsa për vërtetimin e datës 23.04.2024, lëshuar nga shoqëria “{***}” ShPK., për të ardhurat e përfituara nga babai i subjektit D. T., trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti, në kërkesën drejtuar Kolegjit, nuk arrin të provojë dhe të argumentojë mbi pamundësinë objektive që ka pasur për të mos e dorëzuar këtë akt gjatë shqyrtimit të çështjes së tij në Komision. Për rrjedhojë, sa i takon pranueshmërisë së këtij akti, trupi gjykues vlerësoi se nuk mund të merret si provë e re në gjykimin e çështjes në Kolegj, referuar parashikimeve të nenit 47, në kombinim me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 49/2012, sipas së cilave subjekti i rivlerësimit nuk mund të paraqesë në ankim fakte të reja apo të kërkojë prova të reja, përveçse kur provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë shqyrtimit në Komision.

² “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkojnë prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

26. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike, kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit në Komision, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre, sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për të kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i pretendimeve të subjektit mbi aspektet procedurale dhe procesin e rregullt të zhvilluar në Komision

27. Subjekti i rivlerësimit parashtroi në ankim se Komisioni nuk ka respektuar procedurën e marrjes së provave në kundërshtim me përcaktimet e neneve 49/3 dhe 49/4 të ligjit nr. 84/2016, neneve 25 dhe 34 të ligjit nr. 49/2012, si dhe nuk ka respektuar procedurën e vlerësimit të provave në kundërshtim me nenet 48 dhe 81 të Kodit të Procedurave Administrative. Subjekti i rivlerësimit pretendon se shpjegimet e dhëna prej tij gjatë procesit të rivlerësimit lidhur me ndihmën ekonomike të përfituar nga djali, si dhe aktet që janë dorëzuar prej tij për këtë qëllim nuk i janë nënshtruar vlerësimit nga Komisioni, sipas parashikimeve ligjore dhe standardeve të procesit të rregullt ligjor.

28. Subjekti pretendon dhe se Komisioni, në shkelje të parimit të kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve, i ka mohuar të drejtën për t'u dëgjuar në proces, për të prapësuar dhe për të paraqitur kundërgargumentet lidhur me mospërfshirjen e të ardhurave të përfituara nga ndihma ekonomike KEMP në analizën financiare përfundimtare, pjesë përbërëse e vendimit. Komisioni, gjatë të gjithë fazave të procesit të rivlerësimit ka përfshirë të ardhurat nga ndihma ekonomike KEMP si pjesë përbërëse e hetimit dhe i ka përfshirë këto të ardhura në analizën financiare të dërguar së bashku me rezultatet e hetimit, si dhe ka vijuar t'i përfshijë këto të ardhura gjatë relativitetit të konkluzioneve në seancën dëgjimore të datës 27.12.2023. Ndryshimi i qëndrimit të Komisionit për mospërfshirjen e të ardhurave është reflektuar vetëm në vendimin përfundimtar, duke u gjendur në shkelje procedurale, pasi subjekti nuk i është dhënë asnjë mundësi për të paraqitur shpjegimet dhe kundërgargumentet mbi këtë çështje.

29. Lidhur me sa parashtroi subjekti i rivlerësimit në ankim, trupi gjykues fillimisht konstatoi se disa nga këto pretendime kanë të bëjnë me mënyrën e vlerësimit nga Komisioni të shpjegimeve dhe provave të sjella nga subjekti lidhur me të ardhurat nga invaliditeti të përfituara nga djali i tij dhe vlerësimi i tyre do bëhet në vijim në këtë vendim, së bashku me shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

30. Për sa u përket pretendimeve të subjektit që, në shkelje të parimit të kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve, Komisioni i ka mohuar të drejtën për t'u dëgjuar në proces, për të prapësuar dhe për të paraqitur kundërgargumentet lidhur me mospërfshirjen e të ardhurave të përfituara nga ndihma ekonomike, nga verifikimi i akteve në fashikujt e Komisionit, trupi gjykues konstatoi se:

30.1. Në rezultatet e hetimit Komisioni ka konkluduar se: *Në analizën financiare janë përfshirë, të ardhurat e përfituara nga Komisioni Epror Mjekësor Parësor (KEMP), për vitet 2003-2013, nga djali i subjektit, sipas vërtetimit nga Bashkia Vlorë, të sjellë nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 3. Këto të ardhura u morën me rezervë ligjore për shkak të mungesës së nënshkrimit nga ana e titullarit të institucionit.*

30.2. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur me e-mail në datën 18.12.2023, bashkëlidhur dhe aktin vërtetim nr. {***} prot., datë 02.08.2023, i Bashkisë Vlorë, lidhur me të ardhurat e përfituara nga ndihma ekonomike nga E. T., për periudhën 2003-qershor 2014. Ky akt rezulton të ketë nënshkrimin e titullarit të Bashkisë Vlorë.

30.3. Në seancën dëgjimore të datës 27.12.2023, sipas procesverbalit, relatori i çështjes ka relatuar gjetjet e rezultateve të hetimit, si dhe analizën financiare për vitet 2004-20016, në të cilën janë përfshirë dhe të ardhurat e përfituara nga invaliditeti, për vitet 2003-2013, sipas vërtetimit nga Bashkia Vlorë, të cilat janë marrë me rezervë ligjore, për shkak të mungesës së nënshkrimit të titullarit, duke iu kërkuar subjektit që, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ta sjellë vërtetimin në formën e kërkuar nga ligji. Relatori është shprehur në seancë se përgjigjet, shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, Komisioni do t'i vlerësojë me objektivitet në vendimarrjen e tij. Në vazhdim të kësaj seance nuk ka pasur pyetje nga anëtarët e trupit gjykues apo vëzhguesi ndërkombëtar, lidhur me të ardhurat nga invaliditeti apo sqarime të tjera nga subjekti.

30.4. Rezulton se Komisioni në përfundim nuk e ka marrë në konsideratë aktin e sjellë nga subjekti për të vërtetuar të ardhurat nga invaliditeti të djalit, pasi në vendim ka mbajtur qëndrimin se: *Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti nuk e sollti dokumentin - vërtetim në formën e kërkuar nga ligji e, për këtë arsye, Komisioni përfundimisht nuk bëri pjesë të analizës financiare të ardhurat e pretenduara nga Komisioni Epror Mjekësor Parësor (KEMP) për vitet 2003 – 2013. Në analizën financiare u përfshi si e ardhur vetëm vlera e vitit 2014, e cila vërtetohet si e përftuar nga statementi bankar tek Intesa Sanpaolo Bank. Trupi gjykues vëren se është e paqartë nëse Komisioni ka konkluduar mbi dokumentin e parë apo të dytë të paraqitur nga subjekti, dhe nëse është vlerësuar ky i fundit si provë nga Komisioni.*

31. Sa më sipër, trupi gjykues vëren se pavarësisht se në rezultatet e hetimit Komisioni ka konstatuar mangësi në dokumentacionin e sjellë nga subjekti i rivlerësimit, në kushtet kur subjekti ka paraqitur një akt të ri për të cilin nuk ka pasur asnjë vlerësim nga Komisioni, shtuar dhe faktin që në analizën financiare në rezultatet e hetimit janë përfshirë të ardhurat e përfituara nga djali, subjekti ka krijuar pritshmërinë dhe bindjen se këto të ardhura do të ishin pjesë e analizës financiare përfundimtare. Për këto arsye, trupi gjykues vlerëson si të bazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit se nuk i është dhënë e drejta për të prapësuar dhe për të paraqitur kundërgargumentet lidhur me mospërfshirjen e të ardhurave të përfituara nga ndihma ekonomike për djalin e tij.

32. Për sa i përket pretendimit tjetër se Komisioni në shkelje të ligjit procedural nuk i ka dhënë subjektit mundësinë për t'u dëgjuar dhe për të debatuar rezultatin e analizës financiare për periudhën 1998-2003, lidhur me mundësinë e prindërve për të kursyer vlerën prej 1.500.000 lekësh (*depozituar në llogari bankare në emër të subjektit dhe bashkëshortes*), duke i mohuar të drejtën

për të paraqitur prova të tjera në kuadër të mbrojtjes së tij në proces, nga verifikimi i akteve në fashikujt e Komisionit, konstatohet se:

32.1. Në pyetësorin nr. 3, pyetjes nr. 1, mbi burimin e krijimit të depozitave bankare, subjekti i është përgjigjur se: *“Ju sqaroj se burimi i krijimit të dy llogarive depozitë pranë Bankës Intesa Sanpaolo kanë qenë kursimet familjare ndër vite, deri në vitin 2003 dhe 2004, të siguruara nga të ardhurat e ligjshme dhe të deklaruara rregullisht nga ana ime në deklaratat periodike vjetore. Për shkak se deklarimi periodik vjetor plotësohej për herë të parë në vitin 2004 dhe 2005, mungesa e pasqyrimin të këtyre llogarive në deklaratat përkatëse ka qenë një keqkuptim jo i qëllimshëm nga ana ime. [...]. b. Ju sqaroj se burimi i krijimit të llogarisë depozitë pranë Bankës ProCredit kanë qenë kursimet familjare ndër vite deri në vitin 2003, të siguruara nga të ardhurat e ligjshme dhe të deklaruara rregullisht nga ana ime në deklaratat periodike vjetore. Për shkak se veprimet bankare janë kryer nga bashkëshortja K. T. dhe duke qenë se deklarimi periodik vjetor plotësohej për herë të parë në vitin 2004, mungesa e pasqyrimin të kësaj llogarie në deklaratën përkatëse ka qenë një keqkuptim jo i qëllimshëm nga ana ime. [...].”*

32.2. Në rezultatet e hetimit, Komisioni ka konstatuar se sipas analizës financiare të periudhës 1998-2003 rezulton një pamundësi financiare prej 1.470.318 lekësh e subjektit dhe bashkëshortes, për të krijuar këto pasuri likuiditete në bankë dhe për të mbuluar shpenzimet e periudhës.

32.3. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se: *“Deri në vitin 2003, babai D. T. më ka kërkuar të depozitoj në llogari bankare një vlerë prej 1.500.000 lekësh në emrin tim. Prindërit kanë kursyer shumë prej 1.500.000 lekësh nga të ardhurat e pagës, si dhe nga të ardhurat e pensionit të pleqërisë ndër vite. Kjo kërkesë ka ardhur pasi në fillim të viteve 2000, në Shqipëri dhe veçanërisht në qytetin e Vlorës, mbizotëronte një situatë institucionale dhe ekonomike relativisht e pasigurt. Duke qenë se unë kryeja një funksion zyrtar si prokuror, babai ka menduar se do të gëzoja më tepër garanci pranë institucioneve bankare nëse llogaritë do të ishin në emrin tim dhe të bashkëshortes sime. Kjo vlerë lekësh më është dorëzuar cash nga babai im D. T. dhe, më pas, unë e kam depozituar këtë vlerë së bashku me një pjesë të kursimeve të familjes sime në llogaritë bankare depozitë. Këto llogari bankare janë çelur në banka dhe valutë të ndryshme (ISP dhe ProCredit), për të përfutur prej rimarrjes së interesave, sipas kuotave që ofronin bankat në atë periudhë. Për këtë arsye, në analizën financiare të periudhës 1998-2003 duhen përfshirë të ardhurat nga prindërit, në vlerën prej 1.500.000 lekësh, që së bashku me një pjesë të kursimeve të mia familjare deri në atë periudhë, më kanë shërbyer efektivisht për çeljen e depozitave pranë bankave ISP dhe ProCredit”.*

32.4. Subjekti i rivlerësimit, bashkë me prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, ka paraqitur dhe një deklaratë noteriale të babait të tij, me nr. {***} rep., datë 15.12.2023, në të cilën ai deklaroi se në periudhën prej vitit 1998 deri në vitin 2003 i ka kërkuar djalit dhe bashkëshortes së tij të depozitojnë në llogarinë e tyre bankare shumë prej 1.500.000 lekësh, shumë e cila rrjedh nga kursimet e tij dhe të bashkëshortes D. T., nga të ardhurat nga paga dhe pensioni. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, për të provuar pretendimin e tij për mundësinë e prindërve për të kursyer vlerën prej 1.500.000 lekësh për periudhën 1998-2003, ka paraqitur dhe disa vërtetime të

Drejtoria e Rajonale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore Vlorë, për të ardhurat nga puna dhe pensioni për dy prindërit e tij³.

32.5. Në seancën dëgjimore të datës 27.12.2023, përfaqësuesi ligjor i subjektit ka dhënë argumentet në lidhje me hetimin e zhvilluar nga Komisioni, për sa i takon analizës financiare të periudhës 1998-2003, duke parashtruar se: [...] *vlera prej 1.5 milionë lekësh që i është dhënë subjektit ka pasur burim të ardhurat e ligjshme të përfituara nga paga dhe pensioni i pleqërisë së prindërve. Për arsye se këto llogari bankare janë krijuar së bashku me të ardhurat e prindërve, subjekti ka menduar se nuk do ishte e përshtatshme deklarimi i tyre në deklaratën fillestare të vitit 2003. Në përfundim konkludojmë se në analizën financiare 1998-2003 pamundësia që ka konstatuar Komisioni prej 1.470.000 lekësh ka ardhur sepse nuk janë përfshirë në analizë të ardhurat e prindërve në këtë periudhë.*

32.6. Në ankimin drejtuar Kolegjit, subjekti parashtron se babai i tij ka pasur të ardhura të tjera të ligjshme nga punësimi në sektorin privat pas daljes në pension dhe se këto të ardhura nuk janë reflektuar në dokumentacionin e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (në vijim ISSh), por që do të paraqiten prej tij në vijim në proces.

33. Nga sa është parashtruar më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësinë të japë shpjegimet e tij dhe të paraqesë prova lidhur me gjetjet e Komisionit për pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për periudhën 1998-2003, si dhe lidhur me sa ka pretenduar për të ardhurat e prindërve. Mbi këto shpjegime të subjektit është bërë dhe vlerësimi i Komisionit, i cili në vendim ka konstatuar se: *Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka paraqitur një analizë financiare për periudhën 1998 – 2003, ku ka marrë në analizë, sipas dokumentacionit bankar, krijimin e katër llogarive në emër të tij dhe bashkëshortes së tij, duke shpjeguar, ndër të tjera, edhe depozitim të ardhurave të prindërve të tij në vlerën prej 1.500.000 lekësh, në emrin e tij, para të cilat ua ka kthyer atyre përsëri. Ky qëndrim i subjektit u paraqit vetëm në përgjigje të rezultateve të hetimit, pasi nuk ishte pretenduar asnjëherë tjetër gjatë hetimit administrativ. Marrëdhënia e vetme e interesit, e deklaruar nga subjekti gjatë hetimit lidhur me prindërit e tij, është se ata kanë jetuar së bashku për disa periudha dhe se subjekti me bashkëshorten kanë paguar një pjesë të qirasë së banesës ku jetonin. [...] Në asnjë rast [subjekti] nuk i është referuar të ardhurave të prindërve si burim për krijimin e këtyre depozitave, duke ndryshuar kështu qëndrimin e tij të mëparshëm.*

34. Sa më sipër, në përfundim, trupi gjykues çmon se rezultojnë të pabazuara pretendimet e subjektit se në asnjë moment të procesit nuk ka pasur të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të kundërshtuar gjetjet e Komisionit për rezultatin e analizës financiare për periudhën 1998-2003.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

- Për analizën financiare për periudhën 1998-2003

35. Subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se Komisioni ka përjashtuar padrejtësisht nga analiza financiare të ardhurat e prindërve për periudhën 1998-2003, si dhe ka kryer një analizë të pamjaftueshme të mundësisë së prindërve për të krijuar kursime në vlerën prej 1.500.000 lekësh.

³ Sipas shkresave nr. {***} dhe nr. {***}, datë 15.12.2023, të Drejtoria e Rajonale të ISSh-së Vlorë.

36. Komisioni në vendim, lidhur me këto pretendime të subjektit të rivlerësimit, ka konkluduar se: *Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka paraqitur një analizë financiare për periudhën 1998 – 2003, ku ka marrë në analizë, sipas dokumentacionit bankar, krijimin e katër llogarive në emër të tij dhe bashkëshortes së tij, duke shpjeguar, ndër të tjera, edhe depozitim të ardhurave të prindërve të tij në vlerën prej 1.500.000 lekësh, në emrin e tij, para të cilat ua ka kthyer atyre përsëri. [...] Gjithashtu, në përgjigje të pyetësorit lidhur me burimin e krijimit të depozitave, subjekti është përgjigjur se si burim kanë shërbyer kursimet familjare ndër vite deri në vitet 2003 – 2004, të siguruara nga të ardhurat e ligjshme dhe të deklaruara rregullisht nga ai në deklaratat periodike vjetore ose kursimet familjare me të ardhurat e tij nga paga si oficer i policisë gjyqësore Vlorë, prej vitit 1998 e deri në vitin 2000, si dhe të ardhurat nga paga si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, prej datës 01.02.2000 dhe në vazhdim. Pra, në asnjë rast nuk i është referuar të ardhurave të prindërve si burim për krijimin e këtyre depozitave, duke ndryshuar kështu qëndrimin e tij të mëparshëm [...]. Sa më sipër, Komisioni vlerësoi se gjeti të pabazuar pretendimin e subjektit për përfshirjen si burim të krijimit të depozitave deri në vitin 2003 edhe të kursimeve të prindërve të tij.*
37. Komisioni, pavarësisht se nuk i ka konsideruar të bazuara pretendimet e subjektit, gjithsesi, ka analizuar nëse prindërit e subjektit mund të kursenin vlerën prej 1.500.000 lekësh deri fund të vitit 2003, si dhe ka konkluduar se ata rezultonin me pamjaftueshmëri financiare në vlerën prej (-) 578.136 lekësh.
38. Trupi gjykues, nga verifikimi i akteve, konstaton se subjekti në DPV-në 2003 ka deklaruar depozitën *“Të ardhura nga kursimet/ kursime familjare/ Banka e Kursimeve, Vlorë. Vlera: 660.000 lekë”*. Nga hetimi në Komision u evidentuan edhe depozita, të cilat nuk ishin deklaruar në Intesa Sanpaolo Bank në emër të subjektit dhe bashkëshortes prej 1.048.977 lekësh dhe 4.200 USD dhe në ProCredit Bank prej 436.867 lekësh, dhe në total rezultoi ekuivalenti prej 2.602.342 lekësh, të cilat i konfirmon dhe subjekti në prapësimet e rezultateve hetimore.
39. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, pyetja nr. 1, subjekti ka parashtruar se: *“Ju sqaroj se burimi i krijimit të dy llogarive depozitë pranë Bankës Intesa Sanpaolo kanë qenë kursimet familjare ndër vite, deri në vitin 2003 dhe 2004, të siguruara nga të ardhurat e ligjshme dhe të deklaruara rregullisht nga ana ime në deklaratat periodike vjetore. Për shkak se deklarimi periodik vjetor plotësohej për herë të parë në vitin 2004 dhe 2005, mungesa e pasqyrimin të këtyre llogarive në deklaratat përkatëse ka qenë një keqkuptim jo i qëllimshëm nga ana ime. [...]”*
40. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e rezultateve hetimore, ka pretenduar se deri në vitin 2000 ka pasur marrëdhënie familjare shumë të afërta me prindërit e tij, me të cilët kanë jetuar së bashku në një objekt të përbashkët dhe, në këto kushte, disa veprime financiare si çelje e mbyllje depozitash janë kryer nga subjekti. Pra, vlera prej 1.500.00 lekësh i është dhënë subjektit *cash* dhe, më tej, ai ua ka kthyer sërish prindërve të tij, pas tërheqjes nga llogaria në vitin 2004. Për të provuar pretendimet e tij, subjekti, bashkëlidhur prapësimeve, ka paraqitur: (i) deklaratë noteriale të babait me nr. {***} rep., datë 15.12.2023, i cili deklaroi se kursimet e tij prej 1.500.000 lekësh i ka depozituar në llogari subjekti e bashkëshortja e tij; (ii) vërtetime për bazat e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare për prindërit, si dhe vërtetime nga ISSh-ja për të ardhurat nga pensioni. Në analizën që subjekti ka sjellë bashkëlidhur prapësimeve ka konsideruar përfshirjen e vlerës prej

1.500.000 lekësh si “Të ardhura nga prindërit e subjektit për çeljen e depozitave bankare”, duke rezultuar, sipas tij, analiza e periudhës 1998-2003, me diferencë pozitive prej 29.682 lekësh.

41. Subjekti i rivlerësimit në ankim, ashtu si dhe në prapësimet e rezultateve hetimore, pretendon për përfshirjen në analizën e periudhës 1998-2003 të kursimeve të prindërve prej 1.500.000 lekësh. Subjekti pretendon se analiza financiare e kryer nga Komisioni, lidhur me mundësinë e prindërve për të kursyer vlerën prej 1.500.000 lekësh, nuk është realizuar në përputhje me parashikimet ligjore dhe procedurën e duhur dhe Komisioni nuk ka përcaktuar termat e kryerjes së analizës, pasi të ardhurat e prindërve janë gjeneruar ndër vite dhe jo vetëm në periudhën objekt analize.
42. Nga sa evidentuar më sipër, trupi gjykues vëren se subjekti e ka ngritur pretendimin për krijimin e depozitave me burim nga kursimet e prindërve të tij vetëm në prapësimet ndaj rezultateve hetimore. Konstatohet se si në deklaratën e parë periodike vjetore të vitit 2003, ashtu dhe në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar se si burim për krijimin e depozitës/depozitave kanë qenë të ardhurat nga kursimet familjare nga paga. Edhe gjatë hetimit administrativ në Komision, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, konkretisht të pyetjes nr. 1, për burimet e depozitave, subjekti ka deklaruar si burim kursimet familjare të deklaruara në deklaratat periodike vjetore.
43. Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e Komisionit, nuk rezultoi asnjë e dhënë që të mund të provonte dhënien e vlerës prej 1.500.000 lekësh nga prindërit e subjektit për krijimin e depozitave. I vetmi akt që sjell subjekti në mbështetje të pretendimit të tij është deklarata noteriale nr. {***} rep., datë 15.12.2023, dhënë nga babai, bashkëlidhur prapësimeve ndaj rezultateve hetimore, në të cilën ai deklaroi *se në periudhën prej 1998 deri në 2003 i ka kërkuar djalit dhe bashkëshortes së tij që të depozitojnë në llogarinë e tyre bankare shumën e lekëve që kishte prej 1.500.000 lekësh [...] që rrjedh nga kursimet dhe të ardhurat nga paga dhe pensioni i tij dhe bashkëshortes ndër vite*. Trupi gjykues vlerëson se kjo deklaratë noteriale, e parë në raport me të dhënat e tjera, nuk mbështetet nga rrethanat faktike dhe në prova dhe rezulton se nuk ka fuqi provuese, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit⁴.
44. Referuar akteve për të ardhurat e prindërve në vite, sjellë bashkëlidhur prapësimeve, edhe pse nuk u përfshinë në analizën financiare, u verifikua në Kolegj mundësia e kursimeve nga prindërit e subjektit për periudhën 1998-2003, dhe rezultoi një pamjaftueshmëri financiare prej (-) 572.194 lekësh [5.942 lekë më pak se diferenca e Komisionit prej (-) 578.136 lekësh], për krijimin e tyre me burime të ligjshme të provuara.
45. Sa më sipër, në përfundim, trupi gjykues çmon se pretendimet e subjektit të rivlerësimit për përfshirjen në analizën financiare, si burim për krijimin e depozitave të të ardhurave të prindërve për periudhën 1998-2003, mbeten të pabazuara.
46. Për sa u përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave nga ndihma ekonomike për djalin, trupi gjykues vëren se këto pretendime prekin dhe

⁴ Sipas qëndrimeve të mbajtura në jurisprudencën e Kolegjit në vendimet nr. 6/2018 (JR), datë 12.09.2018, paragrafët 35 dhe 36; nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019, paragrafi 27.12.1; nr. 34/2019 (JR), datë 02.12.2019, paragrafi 85.2; nr. 23/2020 (JR), datë 25.09.2020, paragrafi 26.2; nr. 11/2021 (JR), datë 31.03.2021, paragrafi 26.2.

konkluzionin e Komisionit për apartamentin në Vlorë të blerë në vitin 2007 dhe do të trajtohen në shkakun e ankimit në vijim.

- Për pasurinë apartament me sip. 86 m², në Vlorë, të blerë në vitin 2007

47. Në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Apartament me sip. 86 m², me adresë: lagjja “{***}”, Vlorë, blerë në datën 19.11.2007, në vlerën 4.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit të pasurisë apartament: (i) paga e subjektit si oficer i policisë gjyqësore dhe prokuror; (ii) paga e bashkëshortes si punonjëse e Bashkisë Vlorë; (iii) shuma 9.000 USD e dhuruar nga vëllai E. T.”.
48. Në DPV-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar: “Blerje apartamenti, datë 19.11.2007, sip. 86 m², në lagjen “{***}”, Vlorë, në vlerën 4.000.000 lekë. Burimi: pakësuar gjendja cash në shumën 2.8 milionë lekë + 9.000 USD huamarrje nga vëllai me banim në SHBA + kursimet vjetore”.
49. Nga aktet në fashikullin e Komisionit, rezulton se me anë të kontratës së shitblerjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.11.2007, Dorjan Tafilaj e K. T. kanë blerë nga shoqëria “{***}” ShPK pasurinë apartament me sip. 86 m², në Vlorë, në vlerën 4.000.000 lekë.
50. Nga vendimi rezulton se Komisioni, pas kryerjes së analizës financiare përfundimtare për blerjen e apartamentit, ka konkluduar se subjekti dhe bashkëshortja kishin pamjaftueshmëri financiare totale në vlerën prej (-) 440.963 lekësh për blerjen e pasurisë apartament me sip. 86 m², në Vlorë, më datë 19.11.2007. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë apartament në vlerën 4.000.000 lekë, sipas përcaktimeve të shkronjave “a” dhe “b” të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
51. Për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se nga Komisioni është përcaktuar në mënyrë subjektive pamjaftueshmëria e burimeve financiare, në vlerën prej (-) 440.963 lekësh, pasi nuk janë marrë në konsideratë në analizë të ardhurat e përfituara nga ndihma ekonomike e KEMP-it për djalin, në vlerën totale prej 282.000 lekësh, si dhe nuk është kryer nga Komisioni zbritja e shpenzimeve të jetesës për vitet 2005-2007.
52. Lidhur me sa prapëson subjekti i rivlerësimit, nga verifikimi i rezultateve të hetimit, trupi gjykues vëren se Komisioni ka përfshirë në analizën e mundësisë së krijimit të kursimeve për blerje apartamenti në vitin 2007, të ardhurat e djalit nga ndihma ekonomike, për periudhën 01.01.2007 - 19.11.2007, në vlerën prej 95.700 lekësh. Në metodologjinë e rezultateve të hetimit, Komisioni shprehet se: Në analizën financiare janë përfshirë, të ardhurat e përfituara nga Komisioni Epror Mjekësor Parësor (KEMP), për vitet 2003-2013, nga djali i subjektit, sipas vërtetimit nga Bashkia Vlorë, të sjellë nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 3. Këto të ardhura u morën me rezervë ligjore për shkak të mungesës së nënshkrimit nga ana e titullarit të institucionit.
53. Në tabelën e analizës financiare që shoqëron rezultatet e hetimit, janë përfshirë të ardhurat e përfituara nga ndihma ekonomike për djalin, në vlerën prej 76.800 lekësh për periudhën 1998-2003, në vlerën prej 81.600 lekësh për vitin 2004, në vlerën prej 81.600 lekësh për vitin 2005, në vlerën prej 96.000 lekësh për vitin 2006 dhe në vlerën prej 104.400 lekësh për vitin 2007.

54. Në rezultatet e hetimit, Komisioni u referohet dhe shprehet me rezervë për të ardhurat nga ndihma ekonomike për E. T. për periudhën 2003-qershor 2014, pasi në dokumentin vërtetim i Bashkisë Vlorë, sjellë nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 3, mungon nënshkrimi i titullarit të institucionit.
55. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, në datën 18.12.2023, ka dërguar me e-mail dokumentin vërtetim të Bashkisë Vlorë, nr. {***} prot., datë 02.08.2023, për të ardhurat nga ndihma ekonomike për E. T. për periudhën 2003-qershor 2014. Ky dokument mban nënshkrimin e titullarit dhe vulën e institucionit dhe ndodhet në fashikullin e Komisionit, i printuar nga e-mail-i.
56. Komisioni në vendim ka konkluduar se: *“9.16 Në analizën financiare të rezultateve të hetimit ishin përfshirë të ardhurat e pretenduara nga Komisioni Epror Mjekësor Parësor (KEMP) për vitet 2003 – 2013 nga djali i subjektit, sipas vërtetimit nga Bashkia Vlorë, të sjellë nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 3. Këto të ardhura u morën me rezervë ligjore në analizën financiare si të ardhura të ligjshme, pavarësisht se dokumentacioni vërtetues nuk ishte në formën e kërkuar nga ligji, për shkak të mungesës së nënshkrimit nga ana e titullarit të institucionit. Për këtë fakt, subjektit të rivlerësimit iu kërkuar që në përgjigje të rezultateve të hetimit ta sjellë këtë vërtetim në formën e kërkuar nga ligji. 9.17 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti nuk e solli dokumentin - vërtetim në formën e kërkuar nga ligji e, për këtë arsye, Komisioni përfundimisht nuk bëri pjesë të analizës financiare të ardhurat e pretenduara nga Komisioni Epror Mjekësor Parësor (KEMP) për vitet 2003 – 2013. Në analizën financiare u përfshi si e ardhur vetëm vlera e vitit 2014, e cila vërtetohet si e përfituar nga statementi bankar tek Intesa Sanpaolo Bank”.*
57. Nga konkluzioni i Komisionit, konstatohet se si shkak për mospërfshirjen e të ardhurave nga ndihma ekonomike për djalin përbën fakti se subjekti nuk ka provuar me dokumentacion ligjor marrjen e këtyre të ardhurave, pasi, sipas Komisionit, *nuk e solli dokumentin - vërtetim në formën e kërkuar nga ligji.* Trupi gjykues vëren se është e paqartë se cilit dokument i referohet Komisioni në vlerësimin përfundimtar, pasi pavarësisht se në përgjigje të pyetësorit nr. 3 subjekti ka sjellë një vërtetim nga Bashkia Vlorë të pa nënshkruar nga titullari, në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit ai ka paraqitur një vërtetim, me përmbajtje të njëjtë me të parin, me datë dhe numër protokolli dhe të firmosur nga titullari dhe me vulën e institucionit.
58. Për sa i përket qëndrimit të Komisionit se provohet vetëm vlera e të ardhurave nga KEMP-i për vitin 2014, sipas *statement* bankar të Intesa Sanpaolo Bank, nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni, konstatohet në llogarinë bankare në Alpha Bank në emër të E. T. dhe K. T. një transfertë e datës 27.05.2010, pa përshkrim, me vlerë 8.700 lekë që duket se është e njëjtë me vlerat e marra çdo muaj nga Bashkia Vlorë, sipas vërtetimit nr. {***} prot., datë 02.08.2023, të këtij institucioni, dhe që krijon bindjen e trupit gjykues se u takon të ardhurave nga ndihma ekonomike të përfituara nga djali.
59. Nga verifikimi i deklarimeve të kryera nga subjekti, trupi gjykues vëren se në deklaratën *vetting* ai dhe bashkëshortja kanë deklaruar kursime nga të ardhurat e djalit nga KEMP-i si burim për llogarinë bankare në BKT Vlorë. Ndërsa në deklaratimet periodike vjetore, subjekti ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga ndihma ekonomike për djalin, konkretisht: në DPV-në e vitit 2004, ka

deklaruar *kompensim shëndetësor për djalin* 81.600 lekë; në DPV-në e vitit 2006, *asistencë mjekësore KEMP* 48.000 lekë; në DPV-në e vitit 2007, *asistencë mjekësore KEMP* 93.600 lekë; në DPV-në e vitit 2008, *të ardhura vjetore nga KEMP, për të birin* 104.400 lekë; në DPV-në e vitit 2009, *të ardhura vjetore nga KEMP, për të birin* 104.400 lekë; në DPV-në e vitit 2010, *asistencë mjekësore KEMP* 108.000 lekë; në DPV-në e vitit 2011, *asistencë mjekësore KEMP* 111.000 lekë; në DPV-në e vitit 2012, *pagesë KEMP për djalin* 108.000 lekë; në DPV-në e vitit 2013, *pagesë KEMP për djalin* 108.000 lekë; në DPV-në e vitit 2014, *pagesë KEMP për djalin* 108.000 lekë.

60. Trupi gjykues çmon se deklaratat periodike vjetore në vite, të cilat korrespondojnë me të dhënat sipas vërtetimit të Bashkisë Vlorë të datës 18.12.2023, mbështesin pretendimet e subjektit për përfitimin e këtyre të ardhurave. Nisur nga vlera provuese që u jepet deklaratimeve periodike vjetore, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se këto deklarime, si gjurmë të kohës dhe deklarimi në deklaratën *vetting*, së bashku me vërtetimin e bashkisë, si dhe me pagesat e evidentuara në bankë, përbëjnë indicie të mjaftueshme për të provuar përfitimin e këtyre të ardhurave dhe për të konsideruar përfshirjen e tyre në analizën financiare të subjektit, në kundërshtim me qëndrimin e mbajtur nga Komisioni.
61. Për rrjedhojë, duke konsideruar të ardhurat nga ndihma ekonomike për vitin 2003 në vlerën prej 76.800 lekësh, analiza financiare e subjektit të rivlerësimit për vitet 1998-2003, rezulton me pamundësi në vlerën prej (-) 1.470.318 lekësh [në ndryshim nga vlera prej (-) 1.547.118 lekësh që ka konkluduar Komisioni në vendim].
62. Në vijim të arsytimit të mësipërm, duke konsideruar në analizën financiare të viteve 2004 dhe 2006 të ardhurat nga ndihma ekonomike të djalit E. T., përkatësisht për vitin 2004 prej 81.600 lekësh dhe për vitin 2006 prej 96.000 lekësh, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mundësi të krijonin kursime të mundshme në këto dy vite, në total në vlerën prej 1.536.637 lekësh, në të njëjtën vlerë që ka konkluduar dhe Komisioni në raportin e rezultateve të hetimit. Për rrjedhojë, në analizën financiare përfundimtare të mundësisë për blerjen e apartamentit, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja rezultojnë me një pamjaftueshmëri financiare në vlerën prej (-) 263.363 lekësh për blerjen e pasurisë apartament me sip. 86 m², në Vlorë, më datë 19.11.2007, në ndryshim nga vlera prej (-) 440.963 lekësh që ka konkluduar Komisioni në vendim.
63. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankimin drejtuar Kolegjit për zbritje të shpenzimeve të jetesës për vitet 2005-2007, pasi, sipas tij, në periudhën nëntor 2004 - nëntor 2007 familja e tij ka jetuar së bashku me prindërit, të cilët kanë mbuluar shpenzimet e përbashkëta të jetesës sa i përket konsumit ushqimor. Prindërit e subjektit kanë pranuar vetëm pagesën e qirasë mujore prej 6.000 lekësh në muaj. Sipas subjektit, bazuar në Anketën e Buxhetit të Njësive Ekonomike Familjare të INSTAT, shpenzimet për ushqim dhe pije zënë 47.6% të konsumit të familjes dhe diferenca mes vlerës reale totale të shpenzimeve të familjes së tij dhe vlerës së përcaktuar nga Komisioni në analizën financiare është 613.347 lekë, vlerë që ka ndikuar në përcaktimin e mundësisë financiare për blerjen e apartamentit në vitin 2007.

64. Trupi gjykues vëren se këto pretendime subjekti i ka ngritur dhe në Komision, siç rezulton nga prapësimet ndaj rezultateve të hetimit. Komisioni, për sa ka pretenduar subjekti për zbritjen e shpenzimeve të jetesës, ka konkluduar në vendim se: *Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti pretendoi se për shkak të bashkëjetesës me prindërit e tij për periudhën nëntor 2004 – nëntor 2007 duhet t'i zbriteshin shpenzimet e jetesës për zërin e ushqimeve dhe pijeve joalkoolike. Sipas tij, këto shpenzime i ishin mbuluar në atë kohë nga prindërit dhe, për këtë arsye, duhet t'i zbriten në analizën financiare. [...] Subjekti nuk kishte pretenduar më parë zbritjen e këtyre shpenzimeve dhe as ndonjë ndihmë financiare nga prindërit gjatë bashkëjetesës me ta, prandaj Komisioni vlerëson të mos ndryshojë standardin e të këtyre shpenzimeve sipas ILDKPKI-së.*
65. Në analizë të sa pretendon subjekti i rivlerësimit, nga verifikimi i akteve në fashikujt e Komisionit, rezulton se subjekti në asnjë rast nuk ka deklaruar, siç pretendon, për mbulimin e shpenzimeve të jetesës nga prindërit. Ky fakt nuk rezulton të jetë përmendur në deklaratën *vetting* apo në deklaratimet periodike vjetore të pasurisë të viteve 2005-2007. Në përgjigjet e pyetjeve të pyetësorit standard, lidhur me adresën e banimit, si dhe me kë ka bashkëjetuar dhe kush ka paguar shpenzimet e jetesës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar bashkëjetesën me prindërit në një banesë me qira për periudhën nëntor 2004 - nëntor 2007, duke përmendur kontributin e babait vetëm në pagesën e qirasë, por jo përballimin e shpenzimeve të jetesës totalisht nga prindërit. Edhe në deklaratën noteriale të datës 15.12.2023, të lëshuar nga babai i subjektit, përmenden vetëm kursimet në vlerën 1.500.000 lekë për krijimin e depozitave bankare, për të cilat kanë kontribuar prindërit e subjektit me kursimet e tyre, por pa u përmendur ndonjë kontribut tjetër i tyre. Për herë të parë subjekti pretendon se shpenzimet e jetesës për vitet 2005-2007 janë përballuar nga prindërit e tij, vetëm pasi është njohur me rezultatet e hetimit, nga të cilat ka rezultuar me pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e apartamentit në vitin 2007.
66. Pavarësisht këtij vlerësimi, duke ndjekur një qasje garantiste lidhur me pretendimet e subjektit, në Kolegj u krye analiza financiare mbi mundësinë e prindërve të subjektit që me të ardhurat nga pagat dhe pensionet të përballonin dhe pjesën e shpenzimeve të jetesës për vitet 2005-2007 për ushqim dhe pije të familjes së subjektit (46.7% të shpenzimeve të vitit), në total prej 613.348 lekësh. Nga kjo analizë rezulton se prindërit e subjektit kanë një pamjaftueshmëri financiare në vlerën prej 191.463 lekësh⁵ që me të ardhurat e tyre⁶ të përballonin shpenzimet e jetesës së tyre⁷ dhe pjesën e shpenzimeve të jetesës të familjes së subjektit prej 613.348 lekësh.
67. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se mbeten të paprovuara dhe të pabazuara pretendimet e subjektit dhe llogaritja e shpenzimeve të jetesës për vitet 2005-2007 duhet të kryhet ashtu si ka konkluduar Komisioni, bazuar në standardet e shpenzimeve sipas ILDKPKI-së.

⁵ Si rezultat i të ardhurave prej 1.277.353 lekësh, duke zbritur shpenzimet prej 855.468 lekësh dhe duke zbritur dhe pjesën e shpenzimeve të jetesës së familjes së subjektit prej 613.348 lekësh, të pretenduara se janë përballuar nga prindërit.

⁶ Në total për vitet 2005-2007 prej 1.277.353 lekësh: 596.175 lekë të babait të subjektit nga pensioni referuar vërtetimit të ISSh-së për pensionin, nr. {***} prot., datë 15.12.2023; të ardhurat 681.178 lekë të nënës së subjektit nga paga për vitin 2005 dhe pensioni, referuar vërtetimit të ISSh-së nr. {***} prot., datë 15.12.2023.

⁷ Shpenzime prej 855.468 lekësh: total i shpenzimeve të jetesës për dy persona sipas ILDKPKI-së për vitet 2005-2007 prej 711.468 lekësh dhe pjesa e paguar për qiranë prej 144.000 lekësh ose prej 4.000 lekësh muaj.

68. Në përfundim, për pasurinë apartament në Vlorë të blerë në vitin 2007, në ndryshim nga qëndrimi i mbajtur nga Komisioni, vlerësohet se duhet të përfshihen në analizë financiare të ardhurat nga ndihma ekonomike për djalin e subjektit në vlerën totale prej 177.600 lekësh. Në këtë rast pamjaftueshmëria e burimeve financiare të ligjshme për blerjen e pasurisë apartament me sip. 86 m², në Vlorë, në datën 19.11.2007, do ishte në vlerën prej (-) 263.363 lekësh.
69. Për sa më sipër, Kolegji ndan të njëjtin qëndrim me Komisionin se subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e apartamentit në datën 19.11.2007, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b”, pika 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

- Lidhur me llogaritjen e gjendjes cash

70. Trupi gjykues vëren se nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime *cash* në deklaratën *vetting*, ndërsa ka deklaruar gjendje apo kursime *cash* në deklaratat periodike vjetore nga viti 2004 deri në vitin 2016.
71. I pyetur nga Komisioni për arsyet e mosdeklarimit të kursimeve *cash* në deklaratën *vetting*, subjekti, në përgjigjen e pyetësorit nr. 3, ka deklaruar se: *“Ju sqaroj se mungesa e deklarimit nga ana ime të gjendjes cash në fund të vitit 2016 në deklaratën vetting ka qenë një keqkuptim jo i qëllimshëm mbi mënyrën e plotësimit të deklaratës, pasi gjendja e kursimeve cash është deklaruar rregullisht në deklaratat periodike vjetore deri në vitin 2016 [...]. Në asnjë rrethanë nuk ka qenë qëllimi im deklarimi i pasaktë i kursimeve në gjendje cash në deklaratën vetting, duke pasur parasysh se kam deklaruar rregullisht burimet e ligjshme të të ardhurave familjare ndër vite”*.
72. Subjekti, në ankimin drejtuar Kolegjit, parashtrohet se analiza e kryer nga Komisioni mbi ndryshimin e gjendjes *cash* nuk është në koherencë me leximin dhe interpretimin e drejtë të deklarimeve në deklaratat periodike vjetore dhe vlerës provuese të tyre, sipas parashikimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka bërë përllogaritje të gabuara të gjendjes *cash*, pasi nuk ka marrë në konsideratë përdorimin e gjendjes *cash* në shpenzimet për blerjen e automjeteve, çeljen e llogarive bankare, si dhe shlyerjen e detyrimeve në vite.
73. Nga verifikimi i akteve rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje apo kursime *cash* në deklaratat periodike nga viti 2004 deri në vitin 2016, si vijon:
- Në DPV-në e vitit 2004 ka deklaruar: *“Gjendje cash 1.000.000 lekë, 1 janar – 31 dhjetor 2004”*.
 - Në DPV-në e vitit 2005 ka deklaruar: *“Dorjan dhe K. T., kursime familjare 1.000.000 lekë”*.
 - Në DPV-në e vitit 2006 ka deklaruar: *“Kursime familjare 800.000 lekë”*.
 - Në DPV-në e vitit 2007 ka deklaruar: *“Pakësuar gjendja cash për blerjen e apartamentit të lartpërmendur – 2.800.000 lekë. Gjendja deri më 31.12.2007 është 0 (zero)”*. Në këtë DPV ka deklaruar edhe kursime familjare në vlerën 800.000 lekë.
 - Në DPV-në e vitit 2008 ka deklaruar: *“Kursime familjare 600.000 lekë”*.
 - Në DPV-në e vitit 2009 ka deklaruar: *“Kursime familjare 700.000 lekë”*.
 - Në DPV-në e vitit 2010 ka deklaruar: *“Kursime familjare me burim pagat e deklaruesit dhe të bashkëshortes 850.000 (tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, të konvertuara në 6.500 euro. Nga këto kursime, në datën 12.8.2010 është krijuar një depozitë në ProCredit Bank me afat 3-mujor 5.000*

euro dhe në muajin mars të vitit 2010 janë pakësuar për blerjen e një automjeti “Volkswagen Golf” 1.200 euro”.

- Në DPV-në e vitit 2011 ka deklaruar: “Kursime familjare me burim pagat e deklaruesit dhe të bashkëshortes 700.000 lekë”.

- Në DPV-në e vitit 2012 ka deklaruar: “Kursime familjare në lekë cash të krijuara gjatë vitit 600.000 lekë. Pasuri e përbashkët me bashkëshorten”.

- Në DPV-në e vitit 2013 ka deklaruar: “Kursime familjare në lekë cash të krijuara gjatë vitit 400.000 lekë. Pasuri e përbashkët me bashkëshorten”.

- Në DPV-në e vitit 2014 ka deklaruar: “Kursime familjare në lekë cash të krijuara gjatë vitit 2014 500.000 lekë. Pasuri e përbashkët me bashkëshorten”.

- Në DPV-në e vitit 2015 ka deklaruar: “Kursime familjare në lekë cash të krijuara gjatë vitit 2015 300.000 lekë”.

- Në DPV-në e vitit 2016 ka deklaruar: “Shtim pasurie nga të ardhurat si Person Fizik “K. T.” dhe kursime familjare 700.000 lekë”.

74. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të pyetjes për të saktësuar deklarinimin e gjendjes *cash* në vitet 2004 -2016, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se në ndryshim nga deklarinimet periodike vjetore gjendja *cash* për vitin 2004 ka qenë 0 (zero), pasi shuma 1.000.000 lekë e deklaruar si kursime familjare në DPV-në e vitit 2004, është depozituar në llogarinë bankare në Intesa Sanpaolo Bank. Për vitin 2009, subjekti ka sqaruar se gjendja *cash* ka qenë 0 (zero) lekë, pasi kursimet e deklaruara për këtë vit prej 700.000 lekësh kanë përfshirë dhe ato të vitit paraardhës 2008, në vlerën 600.000 lekë dhe janë konvertuar në vlerën 5.000 euro, të depozituar në ProCredit Bank. Për vitin 2012, gjendja *cash* nuk ka pësuar ndryshime (ka mbetur 700.000 lekë si në vitin paraardhës), pasi vlera 600.000 lekë e deklaruar në DPV si kursime për këtë vit, është depozituar në llogarinë bankare në Bankën Kombëtare Tregtare.
75. Komisioni ka konstatuar se sqarimet e dhëna në përgjigje të pyetësorit nr. 2 nga subjekti nuk përputhen me vlerat dhe mënyrën e deklarinimit në DPV-të e viteve 2004 – 2016. Sipas Komisionit, në disa raste, subjekti ka pretenduar se vlerat e deklaruara në DPV si kursime në të vërtetë nuk janë “shtesa”, por “gjendje” *cash*. Në raste të tjera, ai ka pretenduar se vlerat e deklaruara si kursime *cash* në fakt ishin gjendje të depozituara atë vit në bankë.
76. Komisioni, në përfundim të hetimit, ka konstatuar se: - Subjekti nuk ka deklaruar saktë gjendjen *cash* në deklaratat periodike vjetore deri në deklaratën vetting. Ai duket se ka konfuzuar dhe barazuar në deklarinim ndryshimin/gjendjen e likuiditeteve *cash* me ato në bankë. - Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën vetting kursime *cash*, ndërkohë që ka deklaruar shtesë të kursimeve familjare deri në DPV-në e vitit 2016. Sa më sipër, subjektit të rivlerësimit i është kaluar barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e tij për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit.
77. Komisioni ka konstatuar se në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti i rivlerësimit përsëri ka ndryshuar qëndrimin e tij lidhur me kursimet *cash* të viteve 2009-2016, duke sjellë një variant të tretë të gjendjes së vlerësuar *cash* në fund të secilit vit. Në analizën financiare përfundimtare, Komisioni ka përlllogaritur vlerat në *cash*, sipas deklarinimeve periodike të subjektit, duke argumentuar se pretendimet e reja në lidhje me gjendjen *cash*, të ndryshuara nga të mëparshmet,

nuk mund konsiderohen dhe të reflektohen në analizën financiare. Sipas Komisionit, gjendja e likuiditeteve *cash* apo kursimet e shtuara/pakësuara kësaj gjendjeje mund të provohen vetëm nëpërmjet deklaratave periodike vjetore të kohës, si të vetmet dokumente që mund ta provojnë atë, referuar përcaktimeve të ligjit nr. 9049/2003 dhe formularit të deklarimit të interesave private.

78. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, në cilësinë e personit që mbart detyrimin për deklarimin e pasurive dhe interesave privatë, nuk kanë deklaruar saktë gjendjet e kursimeve *cash* dhe/apo shtesat/pakësimet e tyre gjatë viteve, si dhe në deklaratën *vetting* dhe se ai ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë, duke mos u gjendur në kushtet e shkronjës “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
79. Subjekti i rivlerësimit kundërshton përlogaritjen nga Komisioni në mënyrë kumulative të gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratimet periodike. Sipas tij, analiza financiare e kryer nga Komisioni është e shkëputur nga ndryshimet reale që kanë ndodhur në gjendjen *cash* në vite, pasi nuk është konsideruar përdorimi i tepricave të gjendjes *cash* të mbartura përkatësisht sipas viteve për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me çeljen e llogarive bankare në vitet 2009, 2010 dhe 2012, me blerjen e automjeteve “Volkswagen Golf” në vitin 2010 dhe “Ford Focus” në vitin 2015, si dhe shlyerjen e detyrimeve pranë BKT-së në vitin 2015.
80. Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me mënyrën e deklarimit të gjendjes *cash* dhe kursimeve të familjes së tij ndër vite, trupi gjykues sjell në vëmendje se legjislacioni në fuqi, ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, përcakton mënyrën, llojin, objektin dhe afatin e deklarimit të pasurisë dhe interesave privatë dhe ka qenë më se i qartë në drejtim të përcaktimit të detyrimit për deklarim dhe mënyrës së deklarimit. Referuar nenit 4, pika 1, shkronja “d” e këtij ligji, në objektin e deklarimit përfshihet në konceptin e pasurisë së deklarueshme edhe vlera e likuiditeteve në gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, për të cilat, si për çdo pasuri tjetër, duhet të deklarohet gjendja deri më 31 dhjetor, në raport me deklarimin e mëparshëm mbi të njëjtën pasuri. Gjithashtu, neni 7 i të njëjtit ligj përcakton në mënyrë të shprehur se në deklarimin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat private të deklaruar më parë. Në përputhje me përcaktimet e mësipërme ligjore, janë miratuar edhe modelet e formularëve të deklaratimeve periodike, të cilat në rubrikën e ndryshimeve të pasurive dhe interesave privatë, në shpjegimet orientuese për subjektet lidhur me mënyrën e deklarimit, udhëzojnë: *Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesat pakësimet) [...] të çdo lloj pasurie të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit.*
81. Mënyra e deklarimit periodik ka mbetur e pandryshuar, pavarësisht ndryshimeve që mund të ketë pësuar ndër vite ligji i zbatueshëm, lidhur me deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe konfliktin e interesave dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë asnjëherë në kushtet e paqartësisë ligjore në drejtim të detyrimit për deklarim dhe mënyrës së këtij deklarimi.
82. Në rastin e subjektit, Komisioni, bazuar në deklaratat periodike vjetore, ka konsideruar si gjendje likuiditeti *cash* vetëm deklarimin e parë bërë nga subjekti në DPV-në e vitit 2004, sipas deklarimit të subjektit, *gjendje cash 1.000.000 lekë, 1 janar – 31 dhjetor 2004*, ndërsa në vitet në vijim ka

konsideruar si shtesa likuiditeti *cash* deklarimet e subjektit *kursime familjare*. Komisioni, edhe pas propësimeve të subjektit ndaj raportit të rezultateve hetimore, nuk ka konsideruar ndryshime në analizën financiare përfundimtare lidhur me likuiditetet *cash*.

83. Subjekti i rivlerësimit pretendon se leximi i deklaratave periodike vjetore duhet të bëhet ndryshe, pasi në disa raste vlerat e deklaruara prej tij si kursime në të vërtetë nuk janë shtesa, por gjendje *cash*. Sipas tij, pamundësia financiare, sipas analizës financiare të Komisionit, vjen për shkak se Komisioni nuk ka konsideruar se gjendja *cash* është pakësuar për të mbuluar shpenzimet në vite lidhur me çeljen e llogarive bankare në vitet 2009, 2010 dhe 2012, blerjen e automjeteve “Volkswagen Golf” në vitin 2010 dhe “Ford Focus” në vitin 2015, si dhe shlyerjen e detyrimeve pranë BKT-së në vitin 2015.

84. Subjekti i rivlerësimit kundërshton përllogaritjen e gabuar të gjendjes *cash* nga Komisioni për periudhën 2008-2016 dhe konkretisht për vitet 2009, 2010, 2012 dhe 2015. Në shqyrtim të sa pretendon subjekti, si dhe pas verifikimit të akteve në fashikuj, rezulton se:

84.1. Për vitin 2009, në deklaratën periodike vjetore subjekti ka deklaruar “*Kursime familjare 700.000 lekë*”. Në këtë vit ai pretendon se gjendja *cash* e deklaruar dhe mbetur nga viti 2008 është përdorur për të çelur llogarinë bankare prej 5.000 eurosh në ProCredit Bank nga bashkëshortja dhe likuiditeti *cash* në fund të vitit 2009, i deklaruar në DPV-në 2009 prej 700.000 lekësh, është gjendje. Ndërkohë, nga verifikimi i DPV-së 2009, rezulton se subjekti nuk ka deklaruar llogarinë në ProCredit Bank në emër të bashkëshortes dhe, për rrjedhojë, nuk është deklaruar as burimi i pretenduar nga subjekti për krijimin e kësaj llogarie, teprica *cash* e mbartur nga viti 2008.

84.2. Për vitin 2010, subjekti ka deklaruar: “*Kursime familjare me burim pagat e deklaruesit dhe të bashkëshortes – 850.000 (tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, të konvertuara në 6.500 euro. Nga këto kursime, në datën 12.8.2010 është krijuar një depozitë në ProCredit Bank me afat 3-mujor – 5.000 euro. Këto kursime në muajin mars të vitit 2010 janë pakësuar për blerjen e një automjeti tip “Volkswagen Golf” – 1.200 euro*”. Ndërkohë po nga kjo deklaratë rezulton se subjekti nuk deklaron pakësim apo shtim të gjendjes *cash* nga viti paraardhës dhe, sipas deklaramit të tij, kursimet familjare të këtij viti kanë shërbyer si burim për krijimin e depozitës në ProCredit Bank dhe blerjen e automjetit “Volkswagen Golf”. Në deklarimin e kryer nga subjekti nuk ka asnjë të dhënë për përdorimin e tepricave *cash* nga viti paraardhës për blerjen e automjetit tip “Volkswagen Golf”, siç pretendon në ankim.

84.3. Për vitin 2012, subjekti ka deklaruar: “*Kursime familjare në lekë cash të krijuara gjatë vitit 2012. Pasuri e përbashkët me bashkëshorten. Vlera: 600.000 lekë*”. Komisioni në analizën financiare këtë deklaram e ka konsideruar si shtesë të likuiditeteve *cash*. Ndërsa subjekti pretendon se likuiditetet *cash* gjendje për këtë vit janë të pandryshuara, njësoj sa ato në fund të vitit 2011, në vlerën 1.400.000 lekë. Subjekti pretendon se në vitin 2012 bashkëshortja ka hapur në datën 06.04.2012 një depozitë prej 600.000 lekësh në BKT⁸, për të cilën është përdorur likuiditeti *cash* i mbartur në 2011, i zëvendësuar ose shtuar në vlerën prej 600.000 lekësh nga kursimet familjare

⁸ Kjo depozitë është shtuar/pakësuar gjatë viteve dhe edhe pse nuk është deklaruar burimi i saj në DPV-të në vijim, kjo depozitë është gjendje në momentin e deklaramës vetting me vlerën prej 1.804.000 lekësh me burim të deklaruar “*kursime nga paga e subjektit dhe bashkëshortes dhe nga KEMP-i i të birit*”.

vjetore të vitit 2012, duke e ruajtur të pandryshuar gjendjen *cash* në fund të vitit 2012 në raport me gjendjen e vitit 2011, në vlerën prej 1.400.000 lekësh. Konstatohet se në DPV-në e vitit 2012 subjekti, ndryshe nga sa pretendon në ankim, nuk ka deklaruar shtimin e depozitës së bashkëshortes në BKT dhe, për rrjedhojë, as nuk ka deklaruar si burim të depozitës tepëricën *cash* nga viti i mëparshëm.

84.4. Për vitin 2015, në deklaratën periodike përkatëse subjekti ka deklaruar: “*Kursime familjare në lekë cash të krijuara gjatë vitit 2015. Vlera: 300.000 lekë*”. Komisioni në analizën financiare vlerën prej 300.000 lekësh e ka konsideruar si shtesë të likuiditeteve *cash*. Ndërsa subjekti pretendon se likuiditetet *cash gjendje* në vitin 2015 janë në vlerën prej 1.500.000 lekësh dhe janë pakësuar me 800.000 lekë nga gjendja në fund të vitit 2014 që sipas tij ka qenë 2.300.000 lekë. Ky pakësim, sipas subjektit, ka ardhur si rezultat i blerjes së automjetit “Ford Focus” në datën 21.02.2015 prej 688.250 lekësh (ekuivalenti i vlerës 5.000 euro) dhe shlyerjes së detyrimeve në BKT për kreditë gjatë vitit prej 705.000 lekësh. Në shqyrtim të sa pretendon subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren se në DPV-në 2015 subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit “Ford Focus” në datën 21.02.2015, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit, si dhe nuk ka deklaruar burim për shlyerjet e kredive në BKT. Ndërkohë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting* si burim të blerjes së automjetit “Ford Focus” kursimet nga paga dhe kjo vlerësohet si një indicie që, ashtu si pretendon subjekti, likuiditeti *cash* i deklaruar prej 300.000 lekësh dhe tërheqja nga likuiditeti në BKT prej 300.000 lekësh, e deklaruar në DPV-në e vitit 2015, të jetë zëvendësim i vlerës së përdorur prej 600.000 lekësh për blerjen e automjetit në shkurt 2015 nga gjendja likuiditetit *cash* e mbartur në fund të vitit 2014. Për këtë arsye, trupi gjykues çmon se likuiditeti *cash* i deklaruar në DPV-në e vitit 2015 prej 300.000 lekësh është pjesërisht zëvendësim i likuiditetit të mbartur nga viti 2014. Ky qëndrim i Kolegjit ndryshon balancën negative të vitit 2015 në (-) 690.116 lekë, në ndryshim nga konkluzioni i Komisionit për një balancë prej (-)990.116 lekësh, por sërish rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk do të kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për përbalimin e shpenzimeve dhe ripërtëritjen e likuiditetit *cash* të vitit 2014.

85. Në përfundim, për vitet 2009, 2010, 2012 dhe 2015, trupi gjykues vëren se pavarësisht se subjekti ka pretenduar përdorimin dhe, për rrjedhojë, pakësimin e gjendjes *cash* nga viti paraardhës për kryerjen e shpenzimeve, nga deklaratat periodike vjetore nuk rezulton të ketë deklaruar këto shpenzime apo burimin e tyre. Në këto kushte, mosdeklarimi i shpenzimeve të pretenduara në deklaratat periodike vjetore, nisur nga vlera provuese që këto deklarata kanë në procesin e rivlerësimit, e bën të pamundur vërtetimin e pretendimeve të subjektit.

86. Trupi gjykues konstaton se pretendimet e subjektit të rivlerësimit për mënyrën e tij të deklarimeve të *cash*-it jashtë sistemit bankar janë, jo vetëm në kundërshtim me sa parashikojnë dispozitat ligjore, por edhe alogjike në kuptim të nocionit të kursimit. Mënyra e leximit nga subjekti të deklaratave periodike vjetore nuk ka vlerë provuese në drejtim të mënyrës së deklarimit të kursimeve të subjektit dhe të personave të lidhur me të, si dhe të mënyrës së përdorimit të këtyre kursimeve. Nëse subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime *cash* në deklaratat periodike vjetore, atëherë kjo nënkupton që në momentin e inventarizimit të likuiditeteve më 31 dhjetor të vitit të deklarimit periodik, kjo sasi parash përfaqëson një vlerë të identifikuar/deklaruar nga subjekti si gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, që përbën vlerën që sipas tij realisht është kursyer atë vit.

Gjithashtu, deklaratimet kontradiktore të subjektit, lidhur me ndryshimin e gjendjes *cash* në faza të ndryshme të hetimit administrativ në Komision, mosdeklarimi prej tij i shpenzimeve të pretenduara se janë mbuluar nga likuiditetet *cash* të viteve paraardhëse dhe i burimit të këtyre shpenzimeve, si dhe mungesa e deklaratimit për gjendjen *cash* në deklaratën *vetting*, i bëjnë të pabazuara dhe jobindëse pretendimet e tij në këtë drejtim.

87. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të pasaktë të pasurisë, pasi nuk ka deklaruar kursime *cash* në deklaratën *vetting*, ndërsa ka pohuar gjatë hetimit administrativ në Komision se ka poseduar gjendje *cash*, duke u gjendur në kundërshtim me përcaktimet e shkronjës “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
88. Subjekti i rivlerësimit kundërshton dhe gjetjen e Komisionit se në fund të vitit 2016 është mbajtur një gjendje *cash* në vlerën 2.200.000 lekë, që tejkalon vlerën limit prej 1.500.000 lekësh që lejohet sipas ligjit. Sipas subjektit ai ka qenë në kushtet e mbrojtjes së nevojshme për shkak të rrethanave të veçanta të kësaj periudhe, pasi ai dhe familja e tij kanë qenë të ekspozuar ndaj sulmeve kriminale. Në këto rrethana, subjekti ka mbajtur një gjendje *cash* tej limitit të lejuar me qëllim për të siguruar mbrojtjen e familjes në rast emergjence të largimit nga qyteti ku banonin apo jashtë vendit.
89. Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit deklaroi se në fund të vitit 2016 ka pasur gjendje të kursimeve *cash* vlerën prej 2.200.000 lekësh. Kjo vlerë është më e madhe se vlera 1.500.000 lekë, pragu limit i shumës së lejuar për t’u mbajtur e deklaruar gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar (në banesë), sipas ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, me ligjin nr. 45/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklaratimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar”. I pyetur gjatë seancës dëgjimore për këtë fakt, subjekti deklaroi se këtë shumë e mbante për ta përdorur në rast nevojë ekzistenciale për shkak të situatave të ndodhura, dhe se ai dhe familja e tij kanë qenë në gjendje të pasigurt për jetën dhe gjendjen financiare.
90. Për sa rezulton më sipër, vihet re se Komisioni ka konstatuar se subjekti ka pasur në vitin 2016 një vlerë në *cash* tej limitit ligjor, por në konkluzionin përfundimtar subjekti është vlerësuar se ka kryer deklaratim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë (likuiditeteve *cash*). Komisioni e ka penalizuar subjektin jo për shkak të mbajtjes së një shume *cash* tej limitit ligjor, shkelje që trajtohet nga ligji nr. 9049/2003, por për shkak se ka konstatuar mospërputhje në deklaratimet e subjektit në deklaratimet periodike, në deklaratën *vetting* dhe gjatë hetimit administrativ. Në rastin e gjendjes *cash* të pretenduar nga subjekti në vitin 2016, Komisioni ka evidentuar se *subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën vetting kursime cash, ndërkohë që ka deklaruar shtesë të kursimeve familjare deri në DPV-në e vitit 2016*. Rezulton se subjekti në DPV-në 2016 ka deklaruar *shtim pasurie nga të ardhurat dhe kursime* në vlerën 700 000 lekë, ndërsa në deklaratën *vetting*, të dorëzuar në datën 26.01.2017, ai nuk deklaroi gjendje *cash*.
91. Për sa më sipër, trupi gjykues konkludon se pretendimet e subjektit, lidhur me penalizimin e tij nga Komisioni për shkak të mbajtjes së gjendjes *cash* të deklaruar tej limitit ligjor në fund të vitit 2016, janë të pabazuara në ligj.

- Për automjetin tip "Ford Focus" blerë në vitin 2015

92. Subjekti pretendon se konkluzioni i Komisionit, për blerjen e automjetit "Ford Focus", në vitin 2015, nuk është në përputhje me analizën financiare të kryer nga vetë Komisioni, sipas së cilës konstatohet një pamundësi në vlerën prej 282.832 lekësh. Komisioni ka kryer një analizë financiare të pamjaftueshme dhe joproporcionale, pasi nuk ka konsideruar në analizën për blerjen e automjetit tepricën e gjendjes *cash* të mbartur nga viti paraardhës 2014, në vlerën prej 2.300.000 lekësh.
93. Në shqyrtim të këtij shkakui ankimi, nga aktet rezulton se subjekti ka deklaruar në deklaratën vetting: "Ford Focus C Max", me targë {***}, blerë më 21.2.2015. Vlera: 5.000 euro. Pjesa në %: 50%. Burimi kursime nga paga e subjektit si prokuror dhe e bashkëshortes së tij si punonjëse e Bashkisë Vlorë".
94. Në DPV-në 2015, subjekti ka deklaruar: "Blerje automjeti "Ford Focus", prodhim i vitit 2004 me targa {***}, me ngjyrë gri. Vlera: 5.000 euro. Sqarim: automjeti i mëparshëm "Mercedes-Benz", me targa {***} është grabitur (vjedhur me dhunë) më datë 18.11.2014 në qytetin e Vlorës, ku një person i armatosur e i maskuar, pasi ka sulmuar e plagosur djalin tim E. T., ka grabitur automjetin". Në rubrikën të ardhura, subjekti ka deklaruar: "Kursime familjare në lekë cash të krijuara gjatë vitit 2015. Vlera: 300.000 lekë. Llogari bankare në BKT në shumën 2.000.000 lekë deri në datën 31.12.2015, pakësuar me 300.000 lekë data 31.12.2014 me qëllim blerje automjeti".
95. Komisioni në vendim, lidhur me blerjen e këtij automjeti, ka konstatuar se: "3.13 Faktikisht, Komisioni në këtë analizë financiare e kishte marrë në konsideratë pakësimin e gjendjes cash të vitit 2014. Kjo përfshihet në zërin "Ndryshim likuiditeti 31.12.2014 – 21.2.2015", por në këtë zë përfshihet ndryshimi i gjithë likuiditeteve (bankë dhe cash) ndërmjet këtyre dy datave dhe këtu hyn edhe mbyllja e një overdraftit që subjekti kishte në llogarinë e tij të pagës në vlerën -307.609 lekë, të mbyllur në datën 21.1.2015. Vlerësohet si e pamundur ndarja e të ardhurave që shkojnë për shlyerjen e overdraftit dhe atyre që shkojnë për blerjen e automjetit dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera, prandaj të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes së tij (300.749 lekë), si dhe zvogëlimi i kursimeve cash (600,000 lekë) së bashku, nuk mjaftonin për blerjen e automjetit, shlyerjen e overdraftit dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera deri në datën 21.2.2015".
96. Në përfundim, Komisioni, pasi ka kryer përsëri analizën financiare pas rishikimit të të ardhurave totale për të parë mundësinë e subjektit për krijimin e pasurisë automjet tip "Ford Focus" në datën 21.2.2015, ka konkluduar se subjekti dhe bashkëshortja nuk kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit tip "Ford Focus" më datë 21.2.2015, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës dhe se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë automjet, në vlerën prej 688.250 lekësh, në vitin 2015.
97. Nga sa më sipër, konstatohet se në DPV-në e vitit 2015 subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit "Ford Focus" në datën 21.02.2015, nuk ka deklaruar burimin, por ka deklaruar pakësimin e likuiditetit në BKT "Llogari bankare në BKT në shumën 2 milionë lekë deri më datë 31.12.2015, pakësuar me 300.000 lekë nga data 31.12.2014, me qëllim blerje automjeti". Ndërsa në deklaratën

vetting, subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e automjetit: “Kursime nga paga e subjektit si prokuror dhe e bashkëshortes së tij si punonjëse e Bashkisë Vlorë”.

98. Në pyetëSORIN nr. 2, lidhur me burimin për blerjen e automjetit, subjekti ka deklaruar se: “Automjeti tip “Ford Focus”, me targë {***}, është blerë në vlerën 5.000 euro, sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., lidhur në datën 21.2.2015. Fillimisht, burimi financiar i blerjes së automjetit kanë qenë kursimet familjare në gjendje cash, ku është pakësuar përkohësisht gjendja cash në vlerën 600.000 lekë, si dhe të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortes K. T. gjatë vitit 2015. Në vijim, është tërhequr nga llogaria bankare depozitë pranë BKT-së shuma prej 300.000 lekësh, me qëllim ripërtëritjen e gjendjes cash. Ju sqaroj se deri në datën 31.12.2015, gjendja cash është barazuar në vlerën e saj fillestare përpara blerjes së automjetit. Për ripërtëritjen e gjendjes cash ka shërbyer shuma 300.000 lekë e tërhequr nga llogaria bankare depozitë pranë BKT-së, si dhe të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortes K. T. gjatë vitit 2015, në funksion të blerjes së automjetit tip “Ford Focus”.
99. Komisioni në vijim, në analizën e rezultateve hetimore, për analizën pjesore deri në datën 21.02.2015 për blerjen e automjetit “Ford Focus”, ka konsideruar shpjegimet e subjektit për burimet e përdorura në përgjigjet e pyetëSORIT nr. 2 (600.000 lekë nga likuiditetet cash, mbartur nga 2014), sipas së cilës ka rezultuar një diferencë negative prej (-) 263.832 lekësh, ndërsa në vendim ka rezultuar një diferencë negative prej (-) 282.832 lekësh, pasi nuk u konsideruan të ardhurat e pretenduara nga ndihma ekonomike për djalin e subjektit prej 19.000 lekësh⁹.
100. Subjekti, në ndryshim nga shpjegimet e tij në përgjigjet e pyetëSORIT nr. 2, në përgjigjet e rezultateve hetimore dhe në ankimin drejtuar Kolegjit, ka pretenduar përfshirjen në analizë të të gjithë balancës së likuiditeteve cash të vitit 2014, prej 2.300.000 lekësh, duke pretenduar se vlera prej (-) 282.832 lekësh e nxjerrë nga Komisioni si pamjaftueshmëri, në këtë rast nuk është në proporcion me të ardhurat për vitet 2014 dhe 2015. Ky pretendim i subjektit rezulton se është në kundërshtim me sa ka deklaruar ai vetë në përgjigjet e pyetëSORIT nr. 2, ku ka sqaruar se nga gjendja cash e vitit 2014 janë përdorur vetëm 600.000 lekë.
101. Për shkak të deklarimeve të ndryshme të subjektit, lidhur me burimin e blerjes së automjetit “Ford Focus” dhe të përdorimit të gjendjes cash nga viti paraardhës, si dhe të deklarimeve të subjektit për zëvendësimin e vlerës prej 600.000 lekësh me të ardhurat nga pagat Kursime familjare në lekë cash të krijuara gjatë vitit 2015 dhe me tërheqjen prej 300.000 lekësh nga llogaria në BKT, në përfundim, vlerësohet se mbeten të besueshme vetëm deklaratimet e tij për përdorimin e vlerës 600.000 lekë nga cash-i i vitit 2014. Në këto kushte, subjekti, ashtu si ka konkluduar edhe Komisioni, rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e këtij automjeti në datën 21.02.2015, në vlerën prej (-) 282.832 lekësh.
102. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se mbeten të pabazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit për këtë shkak ankimi dhe qëndron konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë automjet në vitin 2015.

⁹ Në vërtetimin e Bashkisë Vlorë për të ardhurat nga KEMP nuk ka të dhëna për vitin 2015.

- Lidhur me mjaftueshmërinë financiare dhe deklarinin e llogarive bankare

103. Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit se është në pamundësi financiare për krijimin e llogarive bankare përkatësisht: depozitës 5.000 euro në datën 27.08.2009, depozitës 5.000 euro në datën 12.03.2010 dhe depozitës 600.000 lekë në datën 05.04.2012, pasi Komisioni për këto depozita nuk ka përfshirë në analizë tepricat *cash* të kursyera në vitet paraardhëse të krijimit të depozitave.
104. Komisioni në vendim ka konkluduar se: *“4.35 Pas shqyrtimit të shpjegimeve përfundimtare, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e konstatimeve, duke u gjendur në kushte pamjaftueshmërie totale të burimeve të ligjshme në vlerën 653.317 lekë (237.038 + 46.818 + 369.462), për krijimin e depozitave: 5.000 euro në datën 27.08.2009; 5.000 euro në datën 11.03.2010; dhe 60.000 lekë në datën 05.04.2012, si dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës dhe shtimin e pasurive, sipas përcaktimeve të shkronjës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016”.*
105. Komisioni ka arritur në këtë konkluzion, pasi konstatoi se subjekti nuk i ka deklaruar depozitat në DPV-të e viteve të krijimit të tyre dhe as ndryshimet e tyre ndër vite, dhe se ka rezultuar me një pamjaftueshmëri financiare totale prej 653.317 lekësh për krijimin e këtyre depozitave ndër vite e, për rrjedhojë, edhe të gjendjes përfundimtare të depozitës në vlerën prej 1.804.000 lekësh, të deklaruar në deklaratën *vetting*.
106. Nga verifikimi i akteve në fashikujt e Komisionit, rezulton se në deklaratën *vetting* subjekti ka deklaruar: *“Llogari bankare pranë BKT-së, dega Vlorë. Vlera: 1.804.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Burimi: kursime nga paga e subjektit dhe bashkëshortes dhe nga KEMP-i i të birit”.*
107. Komisioni ka konstatuar, pas informacionit të dhënë nga bankat, se burimi fillestar i kësaj llogarie është depozita e krijuar në datën 27.8.2009 te ProCredit Bank në emër të bashkëshortes së subjektit në shumën 5.000 euro. Në përgjigje të pyetësorit të dytë, rezulton se subjekti ka deklaruar që burimi i kësaj depozite janë kursimet familjare në gjendje *cash* të viteve 2008 dhe 2009 së bashku. Në DPV-në e vitit 2009, subjekti nuk e ka deklaruar krijimin e depozitës në vlerën prej 5.000 eurosh te ProCredit Bank dhe nuk ka deklaruar as pakësim të kursimeve *cash* të vitit 2008. Komisioni në analizë ka konkluduar se të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes deri në datën 27.08.2009 janë të pamjaftueshme për krijimin e depozitës dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës, duke rezultuar me pamundësi financiare në vlerën prej (-) 237.038 lekësh. Nga analiza e kryer në Kolegj, duke mbajtur të njëjtin qëndrim si Komisioni, pasi subjekti nuk ka deklaruar burimin e depozitës dhe pakësimin e gjendjes *cash*, kjo pamundësi financiare rezulton në vlerën (-)168.320 lekë për shkak se, në ndryshim nga Komisioni, në analizë janë konsideruar të ardhurat e djalit nga ndihma ekonomike për periudhën 01.01.2009-27.08.2009, prej 69.600 lekësh.
108. Në datën 11.3.2010, në llogarinë në monedhën euro te ProCredit Bank, në emër të bashkëshortes është derdhur shuma prej 5.000 eurosh, e cila i është shtuar depozitës së mëparshme në këtë bankë. Kjo depozitë është deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2010, duke deklaruar se: *“Nga këto kursime më datë 12.08.2010 është krijuar një depozitë në ProCredit Bank me afat 3-mujor. Vlera: 5.000 euro”* dhe po në këtë deklaratë ai ka deklaruar: *“Kursime familjare me burim pagat e*

*deklaruesit dhe të bashkëshortes. Vlera: 8.500.000 lekë (shkruhet me fjalë 850.000 lekë) dhe të konvertuara në 6.500 euro". Në përgjigje të pyetësorit të dytë, subjekti ka deklaruar se burimi i kësaj depozite janë kursimet familjare vjetore në shumën prej 850.000 lekësh, të deklaruara në deklaratën periodike përkatëse. Ndërsa në rezultatet e hetimit, subjekti ka sqaruar se si burim për krijimin e kësaj depozite ka shërbyer pjesërisht gjendja *cash* e mbetur nga viti paraardhës 2009, duke mbajtur qëndrime të ndryshme mbi burimin e krijimit të depozitës. Komisioni, pasi analizoi mundësinë e subjektit për krijimin e kësaj depozite me të ardhurat e vitit 2010 deri në datën e krijimit të depozitës më 12.03.2010, ka konkluduar se subjekti dhe bashkëshortja nuk kishin të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e depozitës në ProCredit Bank, në shumën 5.000 euro, në datën 11.3.2010 dhe për mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës, si dhe shtimin e pasurive, duke rezultuar me një pamundësi financiare në vlerën prej (-) 46.818 lekësh. Nga kontrolli i analizës së Komisionit në Kolegj për periudhën 01.01-12.03.2010, subjekti i rivlerësimit rezultoi me një pamundësi financiare në vlerën prej (-) 706.748 lekësh, pasi në ndryshim nga Komisioni u konsideruan të ardhurat e djalit nga KEMP-i prej 26.100 lekësh, u bë korrigjimi i të ardhurave të bashkëshortes, nga 69.217 lekë në Komision në 69.037 lekë (180 lekë më pak se Komisioni), referuar kalimeve në llogarinë bankare, si dhe u bë korrigjimi i shtesës së likuiditeteve bankare nga 109.623 lekë në Komision në vlerën prej 795.473 lekësh (685.850 lekë më shumë se Komisioni). Në Kolegj është konsideruar dhe depozita 5.000 euro (ekuivalenti i saj prej 685.850 lekësh), në ProCredit Bank, investuar në datën 27.8.2009 dhe maturuar në datën 27.8.2010, e cila ka qenë gjendje likuiditeti në periudhën e analizës, deri në datën 12.03.2010.*

109. Vlera e maturuar e llogarisë në ProCredit Bank në shumën 10.292 euro është tërhequr nga bashkëshortja e subjektit në datën 19.09.2011 dhe është depozituar në llogarinë ekzistuese në emrin e saj në BKT, të krijuar në datën 05.04.2012, që kishte gjendjen aktuale në vlerën prej 600.000 lekësh. Për këtë depozitë rezultoi se subjekti nuk ka bërë deklaram në DPV-në e vitit 2012. Nga analiza financiare në Komision, ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshortja nuk kishin të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e depozitës në BKT, në shumën 600.000 lekë, në datën 05.04.2012, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës, duke rezultuar me një pamundësi financiare në vlerën prej (-) 369,462 lekësh. Nga kontrolli i analizës së Komisionit në Kolegj, kjo pamundësi financiare rezultoi në vlerën prej (-) 332.162 lekësh, për shkak se në ndryshim nga Komisioni, në analizë janë konsideruar të ardhurat e djalit nga KEMP-i për periudhën 01.01.2012-05.04.2012, prej 37.200 lekësh, si dhe korrigjimit të të ardhurave të bashkëshortes në shumën prej 129.059 lekësh, 100 lekë më shumë se Komisioni referuar kalimeve në llogarinë bankare.
110. Nga analizimi i gjithë depozitave të krijuara ndër vite, të cilat finalizohen me gjendjen e mbetur të depozitës në fund të vitit 2016 në vlerën prej 1.804.000 lekësh, Komisioni ka konkluduar se nuk vërtetohet mundësia financiare e subjektit dhe bashkëshortes së tij për krijimin e tyre dhe për përballimin e shpenzimeve të tjera në periudhat përkatëse, duke u gjendur në kushte pamjaftueshmërie të burimeve të ligjshme në vlerën totale prej (-) 653.317 lekësh për krijimin këtyre depozitave.
111. Trupi gjykues e vlerëson të drejtë këtë qëndrim të Komisionit, në kushtet kur subjekti nuk arrin të provojë pretendimet e tij për krijimin e depozitave bankare në vite, për të cilat nuk ka deklaruar në

deklarata periodike vjetore krijimin e tyre dhe burimin e krijimit, si dhe ka bërë deklarime kontradiktore për burimin, duke e bërë në këtë mënyrë të pamjaftueshëm deklarin në deklaraten *vetting* të llogarisë bankare pranë BKT-së, e cila ka pasur si burim fillestar këto depozita. Për sa më lart, ankimi i subjektit gjendet i pabazuar në prova.

112. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për krijimin e depozitave, të cilat kanë shërbyer për krijimin e kësaj llogarie, përkatësisht: 5.000 euro në datën 27.08.2009; 5.000 euro në datën 12.03.2010; dhe 600.000 lekë në datën 05.04.2012, si dhe shtimin/krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës, situatë faktike e cila kualifikohet sipas parashikimeve të shkronjës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

- Për automjetin tip “Volkswagen Golf” blerë në vitin 2010

113. Në DPV-në e vitit 2010, subjekti deklaroi: *“Kursime familjare me burim pagat e deklaruesit dhe të bashkëshortes – 850.000 (tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, të konvertuara në 6.500 euro. Këto kursime në muajin mars të vitit 2010 janë pakësuar për blerjen e një automjeti tip “Volkswagen Golf” – 1.200 euro”*.
114. Komisioni ka analizuar mundësinë e subjektit dhe të bashkëshortes për krijimin e kësaj pasurie në vlerën prej 1.200 eurosh me të ardhurat e vitit 2010 deri në datën e lidhjes së kontratës së shitblerjes më 02.03.2010. Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit në datën 02.03.2010, në vlerën prej (-) 56.627 lekësh. Komisioni ka vlerësuar se subjekti në shpjegimet e tij nuk arriti të përmbyste barrën e provës së lënë në rezultatet e hetimit, për shkak se: (a) në DPV-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar shumë qartë që automjeti në vlerën prej 1.200 eurosh ka si burim kursimet familjare me burim pagat e deklaruesit dhe të bashkëshortes; (b) në DPV-në e vitit 2010, subjekti nuk e deklaroi pakësimin e gjendjes *cash* si burim për blerjen e automjetit tip “Volkswagen Golf”; (c) të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes deri në datën 02.03.2010 janë të pamjaftueshme për blerjen e automjetit, shtimin e likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës.
115. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për pamjaftueshmëri financiare në vlerën prej (-) 56.627 lekësh për blerjen e këtij automjeti, pasi, sipas tij, Komisioni ka kryer një analizë financiare të pamjaftueshme dhe joproportionale duke mos konsideruar në analizë tepricën e gjendjes *cash* të mbartur nga viti paraardhës 2009.
116. Lidhur me sa pretendon subjekti i rivlerësimit, rezulton se në DPV-në e vitit 2009 ai ka deklaruar *kursime familjare 700.000 lekë*. Në pyetësin nr. 2, lidhur me pyetjen për gjendjen *cash* në vite, subjekti ka sqaruar se: *kursimet familjare në gjendje cash deri në vitin 2009 kanë qenë 700.000 lekë, të cilat janë konvertuar në valutën euro dhe janë depozituar në llogarinë bankare depozitë*. Ndërsa, për vitin 2010, në këtë pyetësor subjekti ka sqaruar se: *Gjendja cash për vitin 2010 ka qenë 0 (zero) lekë. Kursimet familjare vjetore në shumën 850.000 lekë të deklaruara në deklaratën periodike përkatëse, kanë shërbyer si burim për krijimin e llogarisë së re bankare depozitë pranë ProCredit Bank, në shumën 5.000 euro, si dhe për blerjen e automjetit “Volkswagen Golf 4”, me vlerë 1.200 euro*.

117. Qëndrimi i subjektit ndryshon në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, në të cilat ai parashtron se: *gjendja cash e mbartur nga viti 2009 ka shërbyer si burim fillimisht për blerjen e automjetit, (700.000-166.572=533.428 lekë) dhe në vijim për krijimin e llogarisë bankare depozitë së bashku me kursimet vjetore. Në fund të vitit 2010, gjendja cash është shtuar me 850.000 lekë nga kursimet familjare. Pra, gjendja totale cash në vitin 2010 ka qenë në vlerën 700.000 lekë.*
118. Nga sa rezulton më sipër, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime kontradiktore lidhur me burimin e blerjes së automjetit “Volkswagen Golf 4”, për të cilin në deklarin periodik vjetor 2010 dhe në pyetësorin nr. 2 deklaroi se ka si burim kursimet familjare nga pagat, ndërsa në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit deklaroi se si burim ka qenë teprica *cash* e vitit 2009. Ky kontradiktoritet vjen si rrjedhojë e shpjegimeve të ndryshme që subjekti ka dhënë gjatë hetimit lidhur me likuiditetin *cash* dhe, konkretisht në rastin e këtij automjeti, për gjendjen *cash* në fund të viteve 2009 dhe 2010. Lidhur me deklarinimet e subjektit për likuiditetet *cash* jashtë sistemit bankar, sillet në vëmendje qëndrimi i Kolegjit se deklarinimet për burimet e krijimit të pasurive duhet të gjejnë pasqyrim në përputhje me ligjin, në deklaratën *vetting* dhe ato periodike, përndryshe subjektet vihen në kushtet e pamundësisë për të vërtetuar me deklarime të mëpasshme ekzistencën e tyre, në funksion të procesit të rivlerësimit.
119. Sa më sipër, në lidhje me blerjen e automjetit “Volkswagen Golf 4”, me vlerë prej 1.200 eurosh, në datën 02.03.2010, subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë se si burim për blerjen e tij kanë shërbyer tepricat e gjendjes *cash* të vitit paraardhës 2009. Në këto kushte, bazuar në deklarinimet e subjektit në DPV-në e vitit 2010 se burim i blerjes kanë qenë kursimet nga paga, sipas kontrollit të analizës së Komisionit në Kolegj, ai rezulton me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit në vlerën prej (-) 30.447 lekësh¹⁰.
120. Në përfundim, trupi gjykues, pasi shqyrtoi këtë shkak ankimi të subjektit, vlerëson se pretendimi i tij është i pabazuar në prova dhe konfirmohet konkluzioni i Komisionit se për këtë pasuri subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
121. Subjekti parashtron në ankim se Komisioni nuk ka kryer një vlerësim proporcional dhe të drejtë lidhur me pasuritë e luajtshme të krijuara nga subjekti, dy automjetet, të cilat janë dëmtuar dhe grabitur në datat 29.06.2013 dhe 18.11.2014. Për të dy automjetet subjekti pretendon se duhet t’i jepej dëmshpërblim ose kompensim nga ana e organeve ligjzbatuese, sepse ato janë dëmtuar për shkak të detyrës, dhe se nuk janë zbuluar autorët ndaj të cilëve subjekti mund të kishte kërkuar dëmshpërblim financiar me padi civile.
122. Pretendimin për dy pasuritë e dëmtuara, subjekti e ka ngritur dhe në Komision, i cili e ka vlerësuar si të pabazuar për shkak se, pavarësisht ngjarjeve të ndodhura në dëm të subjektit, në të vërtetë ai i ka krijuar ato pasuri duke shpenzuar për to dhe këto shpenzime/investime nuk mund të mos jenë pjesë e analizës financiare të viteve përkatëse.

¹⁰ Në ndryshim nga analiza e Komisionit, që ka konkluduar për pamjaftueshmëri në vlerën prej 56.627 lekësh, në analizën në Kolegj janë konsideruar të ardhurat e djalit nga KEMP për periudhën 01.01.2010-02.03.2010, prej 26.100 lekësh, si dhe është korrigjuar vlera e të ardhurave të bashkëshortes për periudhën 01.01.2010 -02.03.2010 në 69.037 lekë (80 lekë më shumë se Komisioni).

123. Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, përveç sa ka konkluduar Komisioni që për blerjen e tyre janë kryer shpenzime (të padiktuara nga situata, të paktën në blerjen e automjetit të parë të dëmtuar), trupi gjykues çmon se nuk është në diskrecionin e organeve të rivlerësimit që të bëjnë vlerësimin apo të përfshijnë në analizë financiare vlera të pretenduara nga shkaktimi i dëmit nga të tretët, për sa kohë që këto vlera nuk janë njohur me vendime gjyqësore apo me akte të tjera të organeve ligjzbatuese.
124. Në përmbledhje të sa më sipër, në analizë të situatës faktike dhe ligjore, duke pranuar disa nga pretendimet e subjektit të rivlerësimit, dhe pas kontrollit nga Kolegji të analizës së kryer në Komision, rezultoi që balanca negative e përlloritur nga Komisioni, për periudhën 1998 – 2016, prej (-) 4.547.888 lekësh reduktohet në vlerën prej (-) 3.671.988 lekësh¹¹, me një diferencë nga Komisioni prej 875.900 lekësh, e cila vjen si rezultat i:
- a) konsiderimit në analizën e viteve me rezultate negative të të ardhurave prej 575.900 lekësh¹² nga KEMP-i, duke ulur diferencën negative të viteve 2003, 2004, 2006, 2009, 2010 dhe 2012¹³;
 - b) konsiderimit në analizën e vitit 2015¹⁴ të likuiditetit *cash* prej 300.000 lekësh, jo si shtesë (si Komisioni), por si zëvendësim i pjesëshëm i likuiditetit *cash* të vitit 2014 (prej 600.000 lekësh) i konsideruar i përdorur, në vijim të analizës pjesore që ka bërë dhe Komisioni për automjetin “Ford Focus”, në vitin 2015.
125. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në konkluzionet e mësipërme, çmon se subjekti i rivlerësimit Dorjan Tafilaj, bazuar në nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke u gjendur në kushtet e pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi nr. 728, datë 28.12.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i mbështetur në prova dhe në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

¹¹ Si total i viteve me balanca negative, për vitin 2003 nga – 1.547.118 lekë në – 1.470.318 lekë; për vitin 2004 nga – 353.634 lekë në – 272.034 lekë; për vitin 2006 nga – 187.206 lekë në – 91.206 lekë; për vitin 2009 nga – 732.519 lekë në – 628.119 lekë; për vitin 2010 nga – 110.866 lekë në – 6.166 lekë; për vitin 2012 nga – 626.429 lekë në – 514.029 lekë dhe për vitin 2015 nga – 990.116 lekë në – 690.116 lekë; në total nga – 4.547.888 lekë në – 3.671.988 lekë.

¹² Për vitin 2003 prej 76.800 lekësh, për vitin 2004 prej 81.600 lekësh, për vitin 2006 prej 96.000 lekësh, për vitin 2009 prej 104.400 lekësh, për vitin 2010 prej 104.700 lekësh, për vitin 2012 prej 112.400 lekësh, në total prej 575.900 lekësh.

¹³ Për vitin 2003 nga – 1.547.118 lekë në – 1.470.318 lekë; për vitin 2004 nga – 353.634 lekë në – 272.034 lekë; për vitin 2006 nga – 187.206 lekë në – 91.206 lekë; për vitin 2009 nga – 732.519 lekë në – 628.119 lekë; për vitin 2010 nga – 110.866 lekë në – 6.166 lekë; për vitin 2012 nga – 626.429 lekë në – 514.029 lekë; në total nga – 3.557.772 lekë në – 2.981.872 lekë.

¹⁴ Duke ndryshuar rezultatin negativ të vitit nga konkluzioni i Komisionit prej – 990.116 lekësh në – 690.116 lekë.

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 728, datë 28.12.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Dorjan Tafilaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 18.07.2024, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi